

Rruga e Arbërit



ABONOHUNI NË
GAZETËN "RRUGA
E ARBËRIT"

Cel: 068 31 19 232,
TIRANË - Tel: (04)233 283
PESHKOPI - Tel: 0218 4233

Botim Periodik i Shoqatës "Lidhja e Intelektualëve Dibranë". Viti III i Botimit. Nr. 2(22). Shkurt 2008 Çmimi: 50 lekë, 20 dinarë

NE KETE NUMER:

FJALË NË SEPETE

Puno Gjoka e ha Luca

Nga Naim PLAKU
FAQE 11

Aty ku bashkohet Krajka me Gotvinë

Reportazh nga punimet
në Rrugën e Arbërit
FAQE 3

Shqiptarët, "Fisnikë midis Kombeve" në Muzeumin e Holokaustit në OKB

Nga BEQIR SINA, New York
FAQE 5

Sekrete të mëdha poetësh

Nga Agron TUFA
FAQE 9

Ma shove mallin e ma ndeze brençën, Kozma Traja!

Nga ABDURAHIM ASHIKU
FAQE 8

Mësuesi duhet të njohë mirë të gjithë nxënësit e tij

Nga SHEMSI MANJANI
FAQE 7

Radioamatorizmi Shqiptar mbushi 55 vjeç

(25 vjet nën drejtimin e
Miftar Fanës)
FAQE 10

Zbulohen dy përkrenare ilire në themelet e "Rrugës së Arbërit"

Flet arkeologu, Prof.
As.Dr.Adem Bunguri:

*"Përkrenaret,
një vlerë e
madhe për
arkeologjinë"*

Zbulimi i ndodhur në fshatin Sofraçan, në vendin e quajtur "Qafa e varreve", sipas specialistit në Institutin e Arkeologjisë, Dr. Adem Bunguri, i cili ka shkuar në vendngjarje, ka vlera të mëdha për fushën. Sidomos për faktin se numri i përkrenareve të gjetura deri më tani në të gjithë territorin shqiptar është vetëm 18, çka tregon për një zbulim jo të zakonitë arkeologjik. Ai thotë se zbulimi i këtyre përkrenareve ka një rëndësi të veçantë historiko-kulturore. "Ato plotësojnë njohuritë tona mbi armët mbrojtëse të përdorura nga ilirët, në fazën e vonë të periudhës së hekurit dhe fillimet e periudhës qytetare në Iliri dhe dëshmojnë për nivelin e lartë të kulturës ilire në përgjithësi", shprehet kështu arkeologu Bunguri. Sipas tij, të dyja përkrenaret janë të njëjta, ose të një tipi. Sipas përshkrimit të tij, përkrenaret përbëhen prej një petë monolite bronzi, veshur me një patinë jeshile nga koha e qëndrimit në tokë. Ato kanë hapësen e fytyrës trapezoidale, ndërsa mbrojtëset e faqeve ndahen nga mbrojtësja e mbizverkut në zonën e mbiveshëve me kënd të mprehtë. Kalota është e rrumbullakët dhe përshkohet për së gjati nga dy kreshta simetrike ose shirita plastikë, madje njëra prej tyre ruan deri edhe vrimat për montimin e aplikave zburuese si pendë, pubëz, brirë etj. Buzët e hapjes së përkrenares, si dhe të mbrojtësve të faqeve, janë zburuar nga një shirit dekorativ i puçërruar.



Prof. As. Dr., Adem Bunguri ne vendin ku u gjetën përkrenaret me disa specialistë të firmës ndërtuese të Rrugës së Arbërit, "Almo Konstruktion"

OPINIONE

A duhet të ndërtohet Skavica?!

Nga SHAQIR SKARRA - Faqe 7

Gjiri i Vlorës, lugina e Drinit të Zi dhe...

Nga ABDURAHIM ASHIKU - Faqe 6

Dibranët në Pavarësinë e Kosovës

Pavarësia e Kosovës dhe arroganca serbo-ruse

Dy opinione nga REXHEP TORTE - Faqe 2,5

Gëzuar ditën e madhe!

Nga SAKIP CAMI - Faqe 2

U LARGUA PREJ NESH, PËR NË PËRJETËSI, HAMIT XHAFERRI....

Faqe 8

ABONOHUNI NË GAZETËN "RRUGA E ARBËRIT"

Abonimi vazhdon për periudhën deri në Dhjetor 2008 dhe kushton 50 lekë për numër.

Abonimet në Tiranë mund t'i bëni pranë redaksisë së gazetës në numrat:

Cel: 068 31 19 232 ose në numrat fiks (04) 357 179; 233 283.

Abonimet në Peshkopi mund t'i bëni pranë librarisë "Fleta XXI", pranë Gjimnazit "Said Najdeni", me nr. tel: 0218 4233. Të interesuarit për abonime duhet të lënë patjetër emrin e saktë dhe adresën ku presin t'ju shkojë gazeta.

Duke bërë abonimin tuaj, ju bëheni pjesë e gazetës!

GËZUAR DITËN E MADHE!

Nga SAKIP CAMI

Kombi shqiptar më 17 shkurt festoi një ditë të madhe, ditën e Pavarësisë së Kosovës. Sa e kemi pritur këtë ditë!

U deshën 95 vjet, gati një shekull që kombi shqiptar të fitonte atë pjesë të trupit të tij që ia kishin marrë padrejtësisht, që ia kishin rrëmbyer. Katër vilajetet shqiptare të vitit 1912 u kurrën nga vendimi i fuqive të mëdha të Europës më 1913 dhe më shumë se gjysma e popullsisë shqiptare dhe e trojeve të tij u la jashtë tokës amë, në Greqi, Serbi, Maqedoni e Mal të Zi. Por ky ishte vetëm fillimi i një padrejtësie historike. Doktrina shoviniste e Çubrilloviçit kërkonte t'i shuante dhe t'i shpërngulte shqiptarët nga trojet e veta dhe këto troje të banoreshin nga kolonë serbë. Dhjetëra mijëra shqiptarë të Kosovës u shpërngulën në Turqi. Mijëra të tjerë u shpërngulën në Tiranë, Durrës, Fier e vende të tjera të Shqipërisë. Por kosovarët nuk u ndalën dhe nuk u mposhtën. Çdo familje shqiptare shtohet me nga dhjetë fëmijë. Shqiptaria po shtohet nga dita në ditë. Shkenca e mbrapshtë serbe punonte për çfarosjen e kosovarëve, për sterilizimin e meshkujve dhe femrave shqiptare. Masakrat e tyre arrinin deri aty sa u shponin nënave shqiptare barkun me foshnje, për të mos lindur, për të mos u shumuar. Por shqiptaria dhe shqiptarizmi nuk vdiq dhe nuk vdes kurrë.

Ne jemi një komb vital dhe bujar që prodhon veti dhe vrytete, që ka dhe që ze miq të mëdhenj.

Sa profetike tingëllojnë fjalët e të madhit Fan Noli: Mbahu nëno, mos ki frikë / se ke djemtë në Amerikë. Ishte presidenti amerikan Uillson i pari, ai që nuk lejoi copëtimin e Shqipërisë, ishte presidenti amerikan Clinton ai që urdhëroi dhe drejtoi fushatën e madhe ushtarake 78 ditore kundër Serbisë për të shmangur ekzodin e pashëmbullit serb, ishte presidenti amerikan Bush ai që deklaroi në Tiranë se Kosova do ta fitojë pavarësinë e saj dhe se ka vetëm një plan për Kosovën, plani Ahtisari.

Ishte ambasadori amerikan Uokër ai që ua bëri të ditur të gjitha mediave amerikane e botërore se ç'genocid të pashembullt po bën Serbia në Reçak dhe në mbarë Kosovën, ishte sekretarja e shtetit Ollbrajt ajo që drejtoi marrveshjen e Rambujes në Francë, ishte ambasadori Hollbruk ai që njohu i pari UÇK si forcë ushtarake legjitime, ishte Gjenerali Uesli Klark ai që në krye të forcave të NATO-s drejtoi ushtarakisht fushatën ushtarake duke u kujdesur që të mos vritej edhe një civil i pafajshëm dhe që brenda 78 ditëve e gjuhëzoi makinën ushtarake të Millosheviçit dhe pararendi lirinë e Kosovës.

Mirënjohje të thellë SHBA dhe bijve të saj që nga Presidenti deri tek ushtari i thjeshtë që luftoi për Kosovën.

Mirënjohje të thellë NATO-s dhe trupave të saj që së bashku me UÇK çliruan Kosovën dhe bënë të mundur kthimin e kosovarëve në truallin e tyre në Kosovën e tyre të dashur.

Mirënjohje të thellë Bashkimit Europian, që u solidarizua më Kosovën dhe nuk lejoi që në zemër të Europës në vitin 1999 të zhvilloheshin egzode e tragjedi të tilla njerëzore.

Mirënjohje të thellë të rënëve të Kosovës dhe heroit legjendar Adem Jashari. Me datën 17 shkurt në një kurorë me lule pranë bustit të Adem Jasharit në Tiranë, djemtë e Shqipërisë shkruanin: "Baca Adem, amanet yt u çua në vend, Kosova fitoi pavarësinë."

Mirënjohje të gjithë atyre që kontribuan për këtë fitore të madhe historike, më e madhja në 100 vitet e fundit, të gjithëve, të dukshëm e të padukshëm, më pushkë e me penë, me para e me gjithçka patën. Pa këtë kontribut të jashtëzakonshëm nuk do të ja arrinin kësaj dite.

Një falenderim edhe për ushtrinë shqiptare që në pranverën e vitit 1999 dha ndihmesën e saj, aq sa e lejonin mundësitë dhe ligjet ndërkombëtare të luftës, për t'ja bërë sa më të lehtë që të ishte e mundur UÇK-s dhe NATO-s luftën e tyre.

Më në fund ja arritëm kësaj dite të madhe. Nuk do të ketë më vëllezër të ndarë, nuk do të ketë më genocide e shkelje të të drejtave të njeriut, nuk do të ketë më vuajtje njerëzore të shkaktuara nga ideologji shoviniste. Shqipëria, Kosova dhe Ballkani kanë hedhur sytë drejt Europës së Bashkuar, drejt Bashkimit Europian, drejt ardhmërisë dhe prosperitetit.

Ne jemi një popull vital. Ne dimë të falim dhe të shohim përpara. Ne dimë të qeverisemi dhe të integrohemi në familjen e madhe europiane.

Rruga Durrës-Kukës-Prishtinë, rruga e bashkimit dhe zhvillimit ekonomik po ecën me ritme të shpejta. Të tjerë rrugë të reja po ndërtohen.

Rruga e Arbërit, ajo që po lidh Tiranën me vëllezërit shqiptarë në Maqedoni ka filluar dhe shpresojmë që ritmet e saj të rriten nga dita në ditë.

E gëzofshim ditën e madhe të pavarësisë së Kosovës! Ditë të tjera të mëdha na presin. Punë të mbarë djema!

Dibranët në Pavarësinë e Kosovës

Nga Rexhep TORTE

Për ditën e shpalljes së Pavarësisë së Kosovës më datë 17 shkurt 2008, qindra dibranë udhëtuan drejt Prishtinës dhe qyteteve tjera të Kosovës për ta përjetuar dhe festuar këtë ditë të madhe mbarëshqiptare në mesin e vëllezërve, shokëve dhe miqve kosovarë.

Ndërkaq pushteti vendor dhe Shoqata e të burgosurve dhe përndjekur politikë në Dibër, organizuan në Sheshin "Skenderbej" koncert të madh me këngë, valle e recitime.

Fillimisht nëntë palë daulle dhe zurle me tingujt e tyre kumbues të shoqëruar nga të rinjtë që mbanin në duar flamurin kombëtar shqiptar, jehuan nga lagjet e qytetit për në qendër, duke shprehur simbolikën e Nëntë Maleve të Dibrës, si shembull të kushtrimit, rezistencës luftarake dhe qëndresës shekullore të këtyre anëve në mbrojtje të lirisë dhe kundër armiqve okupues.

Duke festuar shpalljen e Pavarësisë së Kosovës që nga orët e pasdiës e deri në orët e vona të mbrëmjes, para të tubuarve në Sheshin "Skenderbej", u shfaq një program i pasur me këngëtaresh Çiljeta Xhila nga Tirana dhe këngëtarët dhe grupet dibrane A. V. I. Afrona, Daja Do, Balerina, Evzi Kaja, Shkëlqim Agolli, Elmaz Lala, Usher 8701, Riza, Pepi, Besi, Shpëtim Duraku, Minol Noli, Jasmin, Nehat Kupa, Dj. Night Beat dhe Dj. Sound Poëer.

DIBRA DHE KOSOVA ME LIDHJE HISTORIKE TRADICIONALE

Lidhjet e Dibrës me Kosovën janë të thella e të kahmotshme. Për këtë flet zëshëm historia nëpërmjet dokumenteve dhe ngjarjeve të shumta historike, për këtë flasin edhe lidhjet e sotme kulturore e shpirtërore gjithnjë në rritje.

Si rezultat të këtyre lidhjeve tradicionale Iljaz Pashë Qoku-Dibra më 10 qershor 1878 drejtoi punimet e Kuvendit Kombëtar në Prizren, u zgjodh njëzëri kryetar i Këshillit të Përgjithshëm të Lidhjes, njëherësh edhe kryetar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

Patrioti dhe iluministi dibran Said Najdeni, alias Hoxhë Voka-autori i Abetares së gjuhës shqipe dhe i Fe-rrefënjës së Muslimanëve, që jetoi në periudhën e shekullit 19 dhe 20, bashkëpunëtor i Ismail Qemalit, i vëllezërve Frashëri, bashkëpunoi ngushtë edhe me Hafiz Ibrahim Mitrovicën, Haxhi Zekën dhe shumë patriotë të tjerë kosovarë. Pasi vizitoi vilajetet shqiptare Shkodër, Manastir, Kosovë dhe Janinë dhe kolonitë shqiptare në Bullgari, Rumania, Koronë, Bari, Napoli e Romë, në fjalimet e tij në Kosovë, thoshte: "Shqipnia s'ka miq fare dhe që të shpëtojë nga rreziku, një rrugë i ka mbetur. Me u zgjue kombi, me mësuë gjuhën e tij e me i dalë zot vetes".



Këto lidhje të ngushta mes Dibrës dhe Kosovës vazhduan të qëndrojnë dhe ekzistojnë edhe në Luftën e Parë Botërore, pas ndarjes me forcë të trojeve shqiptare dhe gjatë kryengritjeve të njëpasnjeshme për ribashkimin e trojeve të copëtuara shqiptare. Këto lidhje ekzistuan edhe gjatë Luftës së Dytë Botërore, qoftë në aspektin nacionalçlirintar, por edhe në aspektin e Ballit Kombëtar.

THELLIMI I LIDHJEVE KULTURORE E SHPIRTËRORE

Lidhjet shekullore mes Dibrës dhe Kosovës nuk arriti t'i shkëpusë as sistemi pesëdhjetëvjeçar monist i vrazhdë e dinak.

Studentët shqiptarë, Ramiz Kelmendi, Besim Bokshi, Zekerija Cana, Fahredin Gunga, Rexhep Hoxha, Din Mehmeti etj, që studjonin në Universitetin e Beogradit, në nëntor të vitit 1956 themeluan Shoqatën Letrare "Përpjekja", si vatër e rëndësishme ku do të tuboheshin dhe organizoheshin studentët shqiptarë nga Kosova, Maqedonia dhe Mali i Zi.

Në vitin 1968 kjo shoqatë, tashmë letrare-muzikore, kremtoi solemnisht 10-vjetorin e themelimit dhe në bashkëpunim me shoqatat e tjera simotra universitare, organizoi guximshëm, në mënyrë dinjitoze e me plot sukses kremtimin e 500 Vjetorit të vdekjes së Gjegj Kastriot Skenderbeut, në të gjitha qendrat ku studjonin studentët shqiptarë në Beograd, Zagreb, Lublanë, Sarajevë, Prishtinë, Shkup me një program të pasur recitalo-letrar dhe muzikor.

Ali Gojani-kryetar i Shoqatës kulturore e artistike studentore "Ramiz Sadiku" në Prishtinë dhe Rexhep Torte-kryetar i Shoqatës Letrare-Muzikore "Përpjekja" në Beograd, në kuadër të këtij jubileu të vdekjes së Skenderbeut, organizuan që drama e suksesshme "Trimi mirë me shumë shokë" e Sulejman Pitarkës, kushtuar Skenderbeut dhe e përgatitur nga studentët e Prishtinës, me regji të Kristë Berishës, rolin kryesor të së cilës e luante në mënyrë brilante Hasan Salaj, pasi u shfaq në tërë qytetet e Kosovës, të shfaqet edhe në Shkup, Dibër e Strugë.

Në këtë frymë filloi edhe bashkëpunimi mes SHKA "Hajdar Dushi" nga Gjakova me solistët Ismet Peja, Zekerija Çarkaxhiu, Mazllum Mejzini, Nijazi Nikoliqi, Gonxhe Qaushi etj. dhe SHKA "Liman Kaba" nga Dibra, me solistët Sulejman Borova, Violeta Turkeshi, Pranvera Paçuku, Avni Papraniku, me fizarmonikist dhe drejtuesin Eshref Çutra, etj., që u manifestua me vizita dhe koncerte të shumta të ndërsjella.

Ardhja në Dibër e studentëve dhe studenteve të Shoqatës Letrare-muzikore "Përpjekja" e Beogradit dhe e shoqërive tjera kulturore e artistike nga Kosova ishte festë e madhe për dibranët. Për të prituri këta djelmasha gjithnjë dilnin familjarët dibranë. Në këtë mënyrë artistët e rinj shpërndaheshin nëpër familjet dibrane, për tu njohur më mirë me dibranët dhe me bujarinë dhe mikpritjen dibrane. Letrarët e Shoqatës Letrare-muzikore "Përpjekja" Eqrem Kryeziu e Mustafa Cakaj, Rexhep Torte, Nusrete Vula, Faik Mustafa, Ramadan Sinani, etj., këngëtaresh e "Përpjekjes" Hermina dhe Antonata Delhysa, Nezafete Komoni, Osman Hoxha, Bashkim Paloja, Muhamet Shala etj., dirigjenti dhe instrumentalisti Musa Piperku, instrumentalistët Isak Muçolli, Isa Jakupi, Qazim Oruçi, Dashnor Xërxa, Zekerija Ballata, Luigj Gomilla, Rexhep Munishi, Gjergj Kaçinari, Haxhere Kuçani, Perver Shehu, Mehdi Bajri, Atli Piperku, Xhemil Daci etj. dhe prezentesit e programit Vera Gjevori e Faik Hima, vinin me kënaqësi të papërshteruar në Dibër. Këto shoqëri e miqësi të lindura mes dibranëve dhe kosovarëve ekzistojnë edhe sot e kësaj dite.

Themelimi i Universitetit të Prishtinës, e këtij tempulli të dijes dhe kulturës shqiptare, së shpejti u bënë edhe për shumë studentë nga mbarë trojet shqiptare. Në shkollat e mesme profesionale, në shkollat e larta dhe në fakultetet në Prishtinë, Prizren, Pejë, Mitrovicë e Gjilan u regjistruan dhe mbaruan shkollimin më shumë se 600 dibranë dhe dibrane nëpër degë të ndryshme, duke shënuar edhe kulmin e kuadrove të diplomuara dibrane të të gjitha profileve.

(Vijon në faqen 4)

KËSHILLI BOTUES I GAZETËS

Drejtor: RAKIP SULI. Kryeredaktor: SHAQIR SKARRA.
Redaksia: Naim Plaku, Rexhep Torte, Abdurrahim Ashiku,
Prof. Dr. Bashkim Lleshi, Bujar Karoshi
ADRESA E GAZETËS: Blloku i banesave "Gintash", market "KEN", Laprakë.
Tel.068 31 19 232. Tel: (04) 357 179. E-mail: lid_gazeta@yahoo.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin qëndrimin e redaksisë dhe Shoqatës "LID".

Shoqata "Lidhja e Intelektualëve Dibranë",
PROREDIT BANK. Nr. Llog: Në lek 13-661344-0001.
Euro 13-661344-0102. USD 13-661344-0203.

Aty ku bashkohet Krajka me Gotvinë

Nga SHAQIR SKARRA

Mëngjesi është i ftohtë. Në Tiranë filloi të bjerë edhe pak shi i imët. U nisëm herët drejt Bulqizës, me qëllim që të kthehemi vonë në mbrëmje. Edmond Bitri, një djalë i ri i sapo diplomuar për inxhinieri ndërtimi (rruga-ura), e kishte përgatitur makinën qysh në darkë për një udhëtim të tillë. Fundja, ai kishte vajtur shpesh në Bulqizë këto ditët e fundit, pasi firma "Almo Konstruksion", që është administrator babai i tij inxhinier Shaban Bitri, ka fituar lotin 3 në segmentin Ura e Çerenecit-Bulqizë të Rrugës së Arbërit. Qafën e Buallit e lamë pas dhe makina filloi të rrëshqasë në asfaltin e lagur drejt Bulqizës. Lëkundjet e makinës nga gropat e shumta të rrugës nuk na pengonin të hidhnim vështrimin në shpatin matanë. Në fund të luginës janë mbledhur mbeturinat e kromit, i cili të jep përshtypjen e një kavalete të stërmadhe. Këto mbeturina këtu kanë filluar të depozitohen që kur filloi punë fabrika e pasurimit të kromit. Pikërisht tek grumbulli i madh i mbeturinës së kromit, nesër do të fillojë tuneli që do të shpojë tej e tej Qafën e Buallit e ku traseja e Rrugës së Arbërit do të varet poshtë luginës së Planit të Bardhë, Urës së Vashës, Gurit të Bardhë, Qafë Murrizë e më pastaj në Tiranë, për t'u bashkuar me atë që sot quhet edhe në metropolin shqiptar Rruga e Dibrës. Projekti teknik tashmë besoj se është gati dhe për këtë segment të vështirë, ku, sipas zërave, në muajin shtator të këtij viti do të bëhet tenderi për segmentin Bulqizë-Tiranë.

"Mbeturinat e mbledhura të kromit, flitet se do të përdoren në shtrimin e trasesë së rrugës që po ndërtohet", - thotë Mondit, i cili edhe pse mjaft i heshur nga natyra, kur vijnë puna te profesioni nuk të fal edhe për gjërat më të vogla.

E gjithë traseja e hapur e segmentit nga Ura e Çerenecit deri në Bulqizë shtrësia e stabilizantit do të shtrohet me këto mbeturina, ku më pas ajo është gati për shtresën e parë të asfaltit. Bulqiza, megjithëse ishte zgjuar herët, duke jsi e vdekur. Një heshje mortit kishite pillakosur gjithë qytetin minator. Fundja, vdekje kishte. Edhe një tjetër minator doli nga nëntoka i vdekur. Njazi Alliu mbeti në zgafellat e minierës në nivelin e 16-të. Është mëngjes dhe qyteti është zgjuar sot më herët se ditët e tjera, për të përcjellë për në banesën e fundit minatorin Njazi Alliu. Bulqiza është e ftohtë në dimër, por më të ftohtë e bën këtë mëngjes vetë miniera që përpiu edhe një jetë njeriu. E minatorët me trupin e shokut të tyre mbi supe duket sikur thonë: "Po nesër, nesër kush e ka radhën".

Se mos e ka fajin vetëm miniera! Këtu vdekja është e pranishme kudo. Ja dhe stogjet e kromit rrëmbyen një tjetër jetë, një grua fatkeqe, një nënë të pafajshme. Dhe pse? Po mblidhte gurë kromi që të ushqente fëmijët!

PO TANI, O MIKU IM?

Vetëm pak metra na ndajnë aty ku kanë filluar gërmimet e para për Rrugën e Arbërit.

Edhe një sy i pastërvitur mirë kupton qartë se vërtet këto ditë të ftohta zona nga Bulqiza deri tek Ura e Çerenecit është kthyer në një kantier të vërtetë ndërtimi.

Para dy-tre vitesh, kur filloi të dalë në treg gazeta "Rruga e Arbërit", një miku im intelektual nga Dibra më thotë një ditë.

"Jeni nisur në një rrugë që nuk ka as fillim e as fund. Rruga e Arbërit nuk do të realizohet ndonjëherë. Kjo është thjesht një imagjinatë, një ëndërr e kahershme e dibranëve". Sot, këto ditë shkurti, kur traseja e saj është "pushtuar" nga "kënga" e ekskavatorëve dhe makinerisë së rëndë, kur arteria më e



re e vendit zgjatet e zgjatet, kur kodrat e mëdha shemben e kthesat e rrezikshme eliminohen, kur fshatra bashkohen duke hapur useqe deri në njëzet metra thellësi, kur po fillojnë të ndërtohen ura të mëdha dhe mure të larta, miku im i dikurshëm do të habitet e me të drejtë do të bindet se ëndrra po bëhet një realitet.

Makineria e rëndë punon me orë të zgjatura nëpër trasenë më të re, në atë të Rrugës së Arbërit. Po tani, o miku im? Çfarë ke për të thënë tjetër? Kjo rrugë që po hapet është një nga arteriet më të reja që i shtohet vendit dhe është një rrugë bashkëkohore e kategorisë së parë. Kjo distancë prej 17 kilometrash po ndërtohet me një fond prej 17 milionë eurosh, që i takon një milion euro për kilometër. Jo vetëm kaq, por për ta larguar sadopak dyshimin për këtë objekt tepër të rëndësishëm, këtë korridor që bashkon lindjen me perëndimin, në muajin shtator të këtij viti mund të zhvillohet tenderimi i segmentit tjetër të kësaj rruge. Bulqizë - Tiranë, i cili është një nga segmentet më të vështirë që ndërtohet në vendin tonë pas atij Rrëshen - Kalimash.

Përsëri, miku im, mund të shprehet ashtu siç janë shprehur dhe shumë të tjerë. "Po mirë, po pse rruga nuk filloi nga Tirana?" Ky është i vetmi segment që mund të shfrytëzohet tani dhe kur afatin firmat fituese e kanë ta përfundojnë brenda vitit. Nesër po, kur të përfundojë edhe rruga Durrës-Prishtinë, pjesa tjetër siç është ajo Bulqizë-Tiranë do të fillojë patjetër. Fundja, tenderimi për në muajin shtator të këtij viti a nuk është ky një argument bindës.

MES PISHAVE, NJË KANTIER I RI

Po të vinim më parë në Fushë-Bulqizë, këtu nuk do të shikojë asgjë. Vetëm lëvizje makinash në rrugë, pak njerëz që ndalojnë tek teqeja anës rrugës kryesore, tek-tuk ndonjë bujq që pastron arat nga gurët e shumtë dhe asgjë më shumë. Sot është krejt ndryshe. "Këtu fillon loti -1", - tregon Mondit, si gjithmonë i papërtuar kur vjen fjala për trasenë më të re që po hapet. Janë dy firma shkodrane "Albavia" me administrator Hasan Hafizi dhe "Karl Gega" me administrator Shkëlqim Rakipi. Poshtë rrugës është ngritur kantieri ku pushojnë punonjësit dhe shoferët. Këtu edhe flenë, edhe hanë punonjësit. Trajtimi bëhet nga vetë firmat që po ndërtojnë rrugën.

"Kemi pasur mjaft probleme me pronarët - thotë një punonjës që nuk pranon të identifikohet, se ndoshta do të kishim ecur dhe më shumë, por sapo të zgjidhen këto probleme me pronarët, them se do të jemi të parët që do ta përfundojmë objektin. Ndoshta dhe për

vetë faktin se ky segment është paksa ndryshe me të tjerët".

Nuk e patëm fatin të takoheshim me administratorët e këtyre firmave, por kur pamë se si punohej, se si sigurohej lëvizja e mjeteve, kuptuam qartë se shkodranët edhe në punë janë disi ndryshe. Klima e ftohtë e shkurtit nuk i pengonte shkodranët të zgjatëshin drejt fundit të segmentit të lotit -1. Edhe pse në fjalë tregoheshin tepër të rezervuar, traseja ishte zgjatur. Tjetër kulturë rrezaton kudo tek shkodranët.

GURËT E SKËNDERBEUT

Një tjetër kantier ndërtimi dhe pikërisht tek Ura e Qytetit apo siç i thonë ndryshe "Gurët e Skënderbeut". Lartësia këtu është e madhe. Thonë se, pikërisht nga kjo lartësi, Skënderbeu hodhi poshtë një pelë, ku në kokë i kishte vënë një përkrenare.

Banorët, kur e panë, pyesnin njëri-tjetrin: "Pelë është apo dhi" dhe turqit kur panë pelën që plasi dhe i doli gruri që kishte ngrënë, u larguan dhe nuk e mbajtën gjatë rrethimin. "Skënderbeu paska gurë që të ushqejë kafshët dhe jo më për ushtarët".

Sot këto gurë nga poshtë kanë filluar të thërrmohen ku si guri, çakulli gjejnë përdorim të përditshëm. E tashmë që ka filluar dhe Rruga e Arbërit, këtu do të merret dhe shumica e çakullit për shtresat e rrugës.

"Jo i gjithë ky çakull do të përdoret në rrugë", - tregon Mondit si një specialist i mirë, pasi një pjesë është gëlqeror dhe nuk është i përshtatshëm për shtresë, por matanë, në krahun tjetër, ai është më i fortë.

Poshtë këtyre gurëve është ngritur një tjetër kantier. Këtu fillon loti i 2 dhe ndërtojnë këtë segment firma "Delia Group" nga Puka, me administrator Viktor Delia, si dhe "Euraldi" nga Dibra me administrator Ilir Bulkun. Ura e Qytetit mbetet jashtë projektit. Një urë e re këtu do të ndërtohet dhe rruga, që shkurton shumë, duke devijuar trasenë ekzistuese. Ishte orari i pushimit të drekës dhe punëtorët po hanin në kantier. Bashkë me ta edhe drejtori i kantierit, por ekskavatorët ende nuk e kishin lënë punën.

Nuk kishim nevojë për shumë sqarime, pasi vetë puna që ishte kryer bind këdo se këtu kemi të bëjmë me një rrugë të kategorisë së parë dhe një disiplinë që rrallëkund e gjen në këtë periudhë.

SA AFËR QENKA DIBRA ME TIRANËN?!

Po të qëndrosh pak tek "Tre çezmat" dhe të hedhësh vështrimin matanë, duket qartë Ura e Çerenecit. Një kodër e madhe ka filluar të gërmohet dhe rruga devijon nga ajo ekzistuesja. Ky usek është i

thellë mbi 11 metra dhe në të dyja anët e tij do të ndërtohen mure për rrezikshembje. Ky është loti - tre dhe pjesa e fundit ku punojnë bashkë tre firma si "Almo Konstruksion" me administrator inxhinierin me përvojë Shaban Bitri, "Ulza Ndërtim", ku administrator është Nikolin Shpani dhe "G.P.G" me administrator Paqësor Buzi. Drejtor kantieri është inxhinier Thoma Shyti, i cili për asnjë rast nuk largohet nga fronti i punës.

"Është i vetmi segment më i vështiri" - thotë drejtor Thoma. Këtu vetëm skarpatat arrijnë deri në 35-40 metra lartësi. Punohet me shkallë, se ndryshe edhe ekskavatori më i madh nuk e arrin krejt lartësinë. Të gjitha proceset e punëve kryhen me makineri.

Fuqia punëtore, të cilën e kemi marrë nga komunitat ku kryhen punime, më së shumti shërbejnë për përkujdesjen e qarkullimit rrugor. Me këto punime që po kryhen themi me bindje se kemi të bëjmë me një rrugë të kategorisë së parë.

Sa afër qenka Dibra me Tiranën? Unë e dija se Dibra është larg, bile shumë larg. Ky është një fakt. Me ndërtimin e kësaj rruge shkurton shumë. Dibra afrohet shumë me Tiranën. Këtë nuk e kemi ditur se qenka kaq afër!

"Kemi një trajtim të mirë" - thotë Rruzhdi Bitri, ku nga vetë firmat për punonjësit është siguruar hoteli, ushqimi, transporti për në vendin e punës, si dhe transporti kur punonjësit vijnë në Tiranë në çdo dy javë. Një furgon qëndron çdo ditë në gatishmëri pranë frontit të punës.

Përveç tabelave sinjalizuese, këtu nga vetë inxhinieri bëhet instruktimi teknik i punonjësve për vetë frontin e vështirë të punës. "Kemi pasur dhe ne problemet tona" - thotë administratori i firmës "Almo Konstruksion" Shaban Bitri, të cilin të tria firmat së bashku e kanë lënë si inxhinierin më me përvojë, që të ndjekë anën teknike të objektit. Shabanin e gjen shpeshherë në objekt. "Si fillim problemet janë nga më të ndryshmet, - vazhdon bisedën Shabani, sidomos me pronarët. Megjithëse është ngritur një komision i posaçëm për pronat që kalon traseja e rrugës, ende nuk janë bindur të gjithë. Ja, matanë asaj kodre ne filluam, por përsëri i ndërpreme punimet. Është ndoshta një ndër useket më të mëdhenj, që thellësia e tij arrin deri në 22 metra thellësi. Pikërisht ky sek, kur të hapet do të bashkojë dy fshatra Krajken dhe Gotvinë. Ja, ato vërtet fare pranë ndodhen, por nuk e shikojnë njëri-tjetrin.

Është kjo kodër që i pengon. Rruga ekzistuese shkon shumë poshtë me një kthesë tepër të rrezikshme. Nesër, kur të ndërtohet ky sek, distanca e rrugës shkurton, Krajka e Gotvia bashkohen. Ne filluam, por i ndërpreme punimet, se sipër kësaj kodre sipas pretendimeve të vetë banorëve ka qenë një varrezë e vjetër. Ende nuk është zgjidhur asgjë. Ne jemi në pritje që të fillojmë sa më parë. Por jo vetëm kaq. Ka dhe mjaft shtylla të tensionit të lartë që duhet të lëvizin dhe vonesat për të tilla raste sjellin dhe pengesa në realizimin e objektivave që kemi vënë".

Mes "këngës" së ekskavatorëve që punonin deri në orët e vona duke shkërmuqur shkëmbin në trasenë e rrugës më të re, edhe ne u larguam përsëri drejt Tiranës.

E lamë pas dhe Bulqizën, ashtu të zhytur në heshitjen e madhe të vdekjes që i ndodhi.

U larguam për të ardhur përsëri dhe më shpejt, por me një dëshirë që traseja e Rrugës së Arbërit të zgjatet çdo ditë, se ndoshta nuk do të jetë e largët dita kur edhe segmenti tjetër Bulqizë-Tiranë të fillojë të shkërmoqet nga makineria e rëndë dhe Dibra të afrohet me Tiranën, Bulqiza të zgjohet herët, jo për mort e zi, por për punë, gaz e lumturi. Kaq i takon këtij qyteti minator struktur këtu mes maleve. Kromi që fsheh nëntoka e Bulqizës ka rregulluar qytete të tjera, por jo veten e tij.

PIKËPAMJE

Dibra e Madhe kërkon nga USHT hapjen e një fakulteti



Nga REXHEP TORÇE

-Dibra e Madhe e meriton një kujdes dhe vëmendje më të madhe nga të gjitha strukturat shqiptare vendore, qeveritare dhe shtetërore në Maqedoni e më gjerë, qoftë për historinë e saj të begatë, të përgjakshme dhe plot sakrificë për çështjen mbarëkombëtare shqiptare, qoftë për praninë e pishtarëve dibranë të arsimit në të gjitha trojet shqiptare në Maqedoni-

Mediat në Maqedoni në vitin 2006 njoftuan për lajmin e gëzueshëm që për vendimin e Universitetit Shtetëror të Tetovës, që në frymën e dispersionit të fakulteteve në Strugë të hapën Institutin e ekologjisë dhe teknologjisë. Në vitin 2007 USHT hapi fakultetin e arteve aplikative në Gostivar, ndërsa këtyre ditëve u dha lajmi sedo të hapet edhe një fakultet fakultet në Kumanovë.

Çdo nismë dhe hapje e instituteve dhe fakulteteve duhet përshëndetur dhe përgëzuar, sepse është një punë e nderuar dhe në të mirën e të gjithëve.

Tani lind pyetja pse Dibra e Madhe mbetet e lënë pas dore dhe pse nuk ka asnjë nismë apo njoftim konkret që edhe në këtë qytet të hapet ndonjëra nga Degët e USHT-së.

Kjo aqë më tepër kur dihet se Dibra e Madhe së bashku me Tetovën dhe Gostivarin është nënshkruese e Marrëveshjes për themelimin e Universitetit të Tetovës në vitin 1994.

Në Dibër të madhe thonë se asokohe vënia e nënshkrimit të këtyre nuk ishte aspak e lehtë dhe se një nga premtimet kur u nënshkrua Marrëveshja për themelimin e UT-së, ishte edhe hapja e fakultetit pedagogjik në Dibër të madhe. Disa vite më vonë në Dibër të Madhe u zhvilluan edhe provimet pranuese për studenët e fiskulturës dhe flitej se së shpejti këtu do të hapet edhe fakulteti i fiskulturës, por derisot çdo gjë ka mbetur vetëm në suazat e premtimeve.

Dibra e Madhe ka kushte ideale sidomos për hapjen e fakultetit të fiskulturës sepse ka hapësira për ndërtimin e terreneve sportive, ka lumin Radikë, Liqenin e Dibrës së Madhe, ujë e banjave termominerale, ku ekzistojnë të gjitha mundësitë për ndërtimin e pishinave sportive për t'i shfrytëzuar gjatë tërë vitit, ka edhe liqenin për sportet ujore dhe ka edhe terrene sportive për zhvillimin e sportit dimëror të nevojshme për të gjitha aktivitetet e këtij fakulteti. Në bisedat mes dibranëve flitet se për fakultetin eventual të fiskulturës mund të shfrytëzohet edhe ish kazerma ushtarake me godinat dhe ambientet e saj shumë të volitshme.

Megjithatë as në Dibër të Madhe dhe as jashta saj nuk po dëgjojmë të të ndërmerret diçka konkrete në këtë drejtim.

Dibra e Madhe e meriton një kujdes dhe vëmendje më të madhe nga të gjitha systrukturat shqiptare vendore, qeveritare dhe shtetërore në Maqedoni e më gjerë, qoftë për historinë e saj të begatë, të përgjakshme dhe plot sakrificë për çështjen mbarëkombëtare shqiptare, qoftë për praninë e pishtarëve dibranë të arsimit në të gjitha trojet shqiptare në Maqedoni.

Dibra e Madhe në të kaluarën e hershme e lulëzuar dhe qendër e arsimit, e heroizmës dhe e patriotizmës, sot ka mbetur e alivanosur dhe dita ditës po braktiset nga të rinjtë, të cilët të pashpresë janë të detyruar të largohen nga vendlindja.

Hapja e një fakulteti si degë e USHT-së të Tetovës në Dibër të Madhe mbase do ta plotësonte borxhin ndaj këtij qyteti dhe do të ringjallte shpresën për rimëkëmbje në të gjitha fushat e jetës.

Hapja e Instituteve për ekologji dhe teknologji në Strugë, hapja e fakultetit të arteve aplikative në Gostivar dhe paralamërimi i hapjes së një fakulteti edhe në Kumanovë, duhet të shërbejë si shembull i mirë dhe mësim për strukturat udhëheqëse të pushtetit vendor në Dibër të Madhe, për deputetët dibranë dhe për strukturat qeveritare e shtetërore, se duhet të interesohen dhe të jenë më këmbëngulës në kërkesat drejtuar USHT-së dhe institucioneve përkatëse për hapjen e një fakulteti në Dibër të Madhe.

Tani që jemi në prag të nënshkrimit për liberalizimin e vizave mes Shqipërisë e Maqedonisë, tani që tashmë kanë filluar edhe punimet për ndërtimin e Rrugës së Arbërit, kur distanca mes Tiranës dhe Dibrës së Madhe do të jetë vetëm 72 kilometra, gjendemi para një oguri të mirë, se në Dibër të Madhe do të mund të vijmë më lehtë e më shpejtë studentë dhe pedagogë nga Maqedonia dhe Shqipëria.

Hapja e një fakulteti në Dibër të Madhe me siguri do ta mobilizonte edhe mërgatën dibrane për të ndihmuar në këtë drejtim, sepse kjo do t'ia kthente imazhin dhe shpresën Dibrës së Madhe për një zhvillim të gjithanshëm.

Ky tekst le të shërbejë si nxitje dhe obligim për strukturat udhëheqëse dibrane, qeveritare dhe shtetërore që mirëfilli të angazhohen për hapjen e një fakulteti në Dibër të Madhe, por dhe nxitje edhe për Universitetin Shtetëror të Tetovës që t'i kthejë sytë edhe nga Dibra e Madhe, e cila nënshkrimin e saj e ka në themelet e themelimit të këtij tempulli shqiptar të dritës së diturisë e shkencës.

DIBËR E MADHE - Vazhdojnë protestat në fshatin Paresh

Kundër deponisë me mjete demokratike e fizike

Qytetarët e Dibrës së Madhe, Shoqata ekologjike "Deshat", Shoqata e peshkatarëve "Trofta", pushteti vendor i Dibrës dhe fshatarët të Pareshit e të fshatrave tjera të Qendrës së Zhupës, të shtunën më datë 16 shkurt 2008, organizuan protestën e tretë të radhës kundër ndërtimit të deponisë rajonale në Paresh që do ta ndotën liqenin dhe rrethinën e Dibrës së Madhe.

Sazan Papaniku, kryetar i këshillit organizativ të protestave, para protestuesve, deklaroi se: "Kjo deponi ndërtohet në një vend të papërshtatshëm dhe me vendim jokonsensual të KK të Qendrës së Zhupës. Me marrëveshje mes Qeverisë së Italisë dhe Ministrisë së Jashtme të Maqedonisë dëshirohet të ndërtohet një varr i madh ndotës, varr që do ta pengojë zhvillimin e turizmit, të bujqësisë e blektorisë në këtë zonë të virgjër. Fshatarët e Pareshit me një peticion iu drejtuan pushtetit vendor të Qendrës së Zhupës, duke kërkuar ndalimin e ndërtimit të deponisë rajonale që do ta ndotën liqenin e Dibrës së Madhe dhe fshatrat përreth, ndalon revitalizimin e zonës.

Fatmir Alili, ambientalist nga Dibra e Madhe, shtoi se: "Unë jam bashkërendues i studimit të fisibilitetit për trajtimin e mbeturinave për lumin Radikë të pastër nga Mavrova e deri të liqeni i Dibrës së Madhe, për të patur ujëra dhe ambient të pastër në këtë rajon e nëpërmjet Drinit të Zi edhe në Shqipëri. Këtë studim e financoi Programi Phare i UE-së, me çrast komunat e Dibrës së Madhe, Rostushës dhe Qendrës së Zhupës nënshkruan një memorandum bashkëpunimi, ku nuk përmendet fare ndërtimi i ndonjë deponie në Paresh të Qendrës së Zhupës. Ekspertët e këtij studimi vendosën që deponia minirajonale të jetë në Dibër të Madhe



Liqeni i Dibrës së Madhe

ku gjendet deponia aktuale. Dibra e Madhe, Rostusha dhe Qendra e Zhupës nuk ishin trajtuar në Planin ekologjik nacional të Maqedonisë. Konventa ndërkombëtare thotë që për të ruajtur ambientin tënd të pastër nuk duhet ta dëmtosh tjetrën. Dibra e Madhe ka bukuri natyrore që i lakmon tërë bota e nuk duhet që ta ndotim këtë bukuri".

Argëtim Fida, kryetar i komunës së Dibrës së Madhe, theksoi se: "Për këtë deponi rajonale nuk është marë leje na Ministria e ekologjisë e Maqedonisë. Ndërtimi ka filluar vetëm mbi bazën e një dokumenti midis Qeverisë Italiane dhe asaj të Maqedonisë për projektin "Radika e pastër". As italianët dhe as evropianët nuk do të lejonin që projekti "Radika e pastër" ta ndotën liqenin. Komuna jonë me planin gjeneral dhe detal urbanistik parasheh ndërtimin e një fshati turistik dhe kompleks hotelierik në bregun e liqenit, ndërsa në Paresh është në plan ndërtimi i një spitali për rehabilitimin e tuberkulozit. Ndërtimi i Rrugës së Arbërit dhe zgjerimi

i rrugës Dibër e Madhe - Shkup, krijojnë rrethana për investime nga jashtë. Nga fshatarët e Pareshit nuk është marë pëlqim për ndërtimin e deponisë. Këta fshatarë dhe fshatrat përreth kanë mbledhur mijëra nënshkrime kundër kësaj deponie. Për ndërtimin e deponisë nuk është marë pëlqimi nga komunat fqinje të rrezikuara. Nga ky tubim do të dërgojmë letër të tërë përfaqësuesit ndërkombëtarë dhe ambasadat në Maqedoni, Qeverisë Italiane dhe medimeve italiane. Nuk do të lejojmë që mbeturinat e Maqedonisë jugperëndimore të grumbullohen te na. KK i Dibrës së Madhe do të sjell vendim kundër kësaj deponie. Kemi ngritur padi gjyqësore të ndërpriten punimet e deponisë. Ndërtimi i kësaj deponie rajonale ka edhe ngjyrë politike politik, sepse me ndërtimin e kësaj deponie dëshirohet moskthimi i mërgimtarëve dhe shpërngulja totale e Dibrës së madhe dhe rrethinës. do ta pengojmë ndërtimin e deponisë me mejte demokratike dhe fizike".

R. TORÇE

Dibranët në Pavarësinë e Kosovës

(Vijon nga faqja 2)

Funksionarët e atëhershëm kosovarë dhe shefat e katedrave nëpër fakultete asnjëherë nuk e vunë në pyetje regjistrimin e studentëve shqiptarë nga Maqedonia, e sidomos të atyre nga Dibra, gjë që dibranët nuk e harrojnë asnjëherë.

Kuadrot shqiptare të diplomuara në Kosovë sot janë bartës të zhvillimit arsimor në fakultetet me mësim në gjuhën shqipe në Shkup dhe Tetovë.

UKSHIN HOTI NË DIBËR NDJEHEJ SI NË SHTËPINE E TIJ

Ukshin Hoti-simboli i rezistencës kosovare ndaj okupimit serb, sa herë që vinte në Dibër, ndjehej si në shtëpinë e tij. Kjo bëri që Haki Torçe-plaku 97 vjeçar dibran, duke e njohur për nga afër Ukshinin, më 3 shkurt të vitit 2000, iu drejtua me një letër të hapur Bil Klintonit, Kofi Ananit, Toni Blerit dhe shumë personaliteteve tjera me kërkesën "Ju lutem ta gjeni e ta lironi Ukshin Hotin", letër që u botua në mediat shqiptare.

Këto lidhje të dëshmuara me vite erdhën në shprehje edhe në vitin 1999 gjatë rezistencës heroike të UÇK në Kosovë për të mbrojtur popullin nga gjenocidi serb. Në radhët e UÇK pati edhe dibranë.

Gjatë ekzodit kosovar mars-qershor 1999, në Dibër gjetën strehimin dhe bujarinë dibrane 6500 vëllezër e motra kosovare.

Në shej përkujtimi në Dibër është zbuluar edhe pllaka përkujtimore e Kosovës, në të cilën janë gëdhendur vargjet e Ali Podrimës "Dibra ishte Kosovë e vogël dhe Kosova plagë e saj".

Këto lidhje mes Dibrës dhe Kosovës tashmë janë përforcuar edhe shtuar.

Çdo ditë në ora 5 të mëngjezit nga Sheshi "Skenderbe" në Dibër, nisët për në Prishtinë furgoni me pasagjerë dhe anasjelltas po të njëjtën ditë në ora 14 nga "Santea" e Prishtinës për në Dibër. Këtë linjë e vendosën vëllezërit Nizamedin dhe Galip Papaniku fill pas çlirimit të Kosovës në vitin 1999 dhe është duke funksionuar edhe sot e kësaj dite.

Ndërmjet Dibrës dhe Kosovës veç shoqërisë dhe miqësisë, sot ka edhe shumë martesë të ndërsjella. Këtë e dëshmon edhe prania e dibranëve në Kosovë dhe anasjelltas në rastet e gazmendeve dhe hidhëremeve.

Dibra dhe Kosova e kanë edhe një simbolikë të përbashkët. Më 28 nëntor 2001 në Prishtinë u inaugurua Përmendorja e Skenderbeut, ndërsa më 2 mars 2003 në Dibër u inaugurua Shtatorja e Skenderbeut. Në këto evenimente të rëndësishme historike dibranët ishin në Kosovë dhe kosovarët në Dibër.

Në vitin 2007 u bë edhe binakëzimi ndërmjet komunës së Dibrës dhe Komunës së Gjakovës. Këto lidhje mes dibrës dhe Kosovës do të shtohen dhe fuqizohen edhe më shumë tani që u shpall edhe Pavarësia e Kosovës.

R. T.

Pavarësia e Kosovës dhe arroganca serbo-ruse

Shpallja e Pavarësisë së Kosovës më datë 17 shkurt 2008, dëshmoi edhe njëherë shpirtin plot urtësi dhe fisnik të popullit shqiptar. Dëshmoi se ne shqiptarët dijmë të kërkojmë, të luftojmë, të gëzojemi dhe të respektojmë dëshmorët e rënë dhe miqtë tanë. Mundësitë elektronike mediatike informuan botën për karakterin dinjitoz, human dhe demokratik të shqiptarëve të dëshmuar me shekuj. Nuk ekziston asnjë rrjesht i shkruar apo dokument historik, që shqiptarët të kenë okupuar qoftë edhe një pëllëmbë toke të huaj.

Shpallja solemne e Pavarësisë së Kosovës, e Republikës së Kosovës dhe deklarata e pavarësisë e lexuar para afër dy mijë përfaqësuesve të mediave botërore, përbënte mesazhin e qartë, se në Kosovën e Pavarur, në këtë shtet më të ri në botë, të gjitha komunitetet dhe veçanërisht komuniteti serb, do të jenë të barabartë. Udhëheqësia e Kosovës shprehu qëndrimin korrekt e dinjitoz, vullnetin dhe gatishmërinë e sigurtë, për të siguruar paqe të qëndrueshme në Kosovë dhe Ballkan, duke garantuar zbatimin e pakos së Ahtisarit, ku pakicës serbe mbi bazën e decentralizimit i jepen teritorë dhe kompetenca që nuk i ka sot asnjë pakicë në cilindo shtet të botës.

Serbia edhe pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës është duke demonstruar vetëm nervozizëm dhe agresivitet.

Bushtetasit dhe liderët serbë dhe Kisha ortodokse serbe me deklaratat e tyre, se Serbisë ju morën 15 përqind të teritorit të saj, harrojnë të kaluarën e përgjakshme dhe janë vënë në nxitje të protestave huliganeske dhe shkatërruese, për të shprehur vrin kundër Republikës së Kosovës që tashmë po hecën rrugës demokratike dhe të mbështetur fuqimisht nga bota e përparuar ndërkombëtare. Protestat shkatërruese ndaj ambasadave dhe bizneseve të huaja në Beograd, tërheqja e ambasadorëve nga shtetet që e pranojnë Pavarësinë e Kosovës, hudhja e mjeteve shpërthyes ndaj përfaqësive të huaja në veri të Mitrovicës dhe djegia e objekteve doganore në pikat kufitare në Leposaviq dhe Zubin Potok, tregojnë paafësinë dhe rrugën pa krye në të cilën shkon Serbia.

KUFIJTË E SERBISË JANË ZGJERUAR ME GJAK

Të dhënat historike në mënyrë të pakontestueshme flasin qartë se Serbia ka qenë një shtet në miniaturë sa Sanxhaku i Beogradit, dhe se zgjerimi i tij është bërë gjithnjë nëpërmjet okupimeve të trojeve të huaja me vrasje e djegie, e më së shumti të trojeve shqiptare.

Këto të dhëna historike dhe shkencore, dëshmojnë edhe nëpërmjet një Faksimili të Hartës së Enciklopedisë Ruse të vitit 1817, ku shihen qartë kufijtë realë të Serbisë në atë periudhë dhe në vitet 1804, 1810, 1812, 1815, 1820, 1867, që janë shënuar në brendinë e kësaj harte. Kjo tregon qartë se kufijtë e sotëm të Serbisë janë arritur vetëm nëpërmjet ekspeditave të përgjakshme serbe ndaj fqinjëve dhe sidomos ndaj trojeve shqiptare.

Jemi dëshmitarë të ofensivës ushtarake, paramilitare dhe policore serbe në vitin 1999 në Kosovë, të shoqëruar me mijëra vrasje makabëre të popullatës së pafajshme shqiptare, mes tyre edhe të fëmijëve, pleqve dhe grave shtatzëna, me djegie të dhjetëra mijërave shtëpive shqiptare, me përdhunime të fëmijëve para prindërve dhe të prindërve para fëmijëve, me kidnapime dhe zhdukje dhe me dëbimin e afër një milion shqiptarëve nga vatrën e tyre në Kosovë.

PAVARËSIA E KOSOVËS E DEMOKRATIZON SERBINË

Për shtetarët, liderët dhe kishtarët ortodoksë serbe dhe për mbështetësit e tyre brenda dhe jashtë Serbisë, do të ishte më i ndershëm dhe i dobishëm pranimi i Pavarësisë së Kosovës, se sa orvatjet e turpshme e mashtruese për ta mbuluar dhe mbrojtur fajësinë historike serbendaj shqiptarëve.

Askush në botë nuk mund të nxjerr edhe fakt të vetëm që shqiptarët të kenë okupuar edhe një pëllëmbë toke të huaj, gjë që është e kundërta me serbët, të cilët me shekuj në gjenin dhe në mëndjen e tyre e kanë vrasjen dhe okupimin.

Hegjemonisë dhe ekspansionit serb i ka ardhur fundi. Sa më heret që ta kuptojnë serbët, aq më mirë do të jetë për Serbinë. Treni i demokracisë dhe ardhmërisë së lumtur për Republikën e Kosovës nuk do të ndalet kurë për të mirën e popullit të Kosovës dhe të rajonit.

R. TORTE

Shqiptarët, "Fisnikë midis Kombeve" në Muzeumin e Holokaustit në Kombet e Bashkuara

Ndregjoni, familja dibrane, e cila shpëtoi familjen çifute prej shtatë anëtarësh, gjatë Luftës së Dytë Botërore, u nderua në New York, nga Yad Vashem

Nga **BEQIR SINA, New York**

NEW YORK CITY : Familja Ndregjoni, nga fshati Lukan - Dibër, fshat i thellë malor, i cili gjendet në majën e kreshtave të malit, që mban emrin Mali e Runjes (2.047 m mbi nivelin e detit), (Latitude : 41.6644 -Longitude : 20.2527), askërkush, nuk do ta dinte se ajo ishte bërë strehë e një familje çifute (hebreje), gjatë Luftës së Dytë Botërore, po të mos ishin hapur dokumentat e arshivave shtetërore. Gjithçka, në zbulimin e këtyre dokumentave, të cilat po vertetojnë se asnjë çifutë nuk iu dorzua nazi-gjermanëve nga shqiptarët, dhe se shqiptarët, u bë shpëtimtarët e çifutve që kërkuan mbrotjen e tyre në Shqipëri, ka si nismë një udhëtim të ish kongresmenit me origjinë shqiptare Josph J. DioGuardi, presidenti i Ligës Qytetare Shqiptaro-Amerikane, që në Janar 1989, duke çuar edhe kongresistit Tom Lantos, i mbijetuar i Holokaustit, në Shqipëri, e Kosovë në Maj 1990.

Kjo, ndodhi veçse disa ditë më vonë, pasi ata kishin udhëtuar së pari për në Shqipëri për të konfrontuar regjimin komunist të pasardhësit të Enver Hoxhës, Ramiz Alia, duke kërkuar nga ai që të hapte kufijtë e Shqipërisë, dhe për të lejuar valet e demokracisë, që po rrihnin edhe Evropën Lindore e po hynin ngadal-ngadal edhe në Shqipëri, thuajse një vit pas rënies së Murit të Berlinit. Një nga kërkesat e tyre kryesore, at'here që hapja e arshivave të shtetit shqiptar. Me dokumentat, të cilat tregojnë sesa familje çifute u strehuan në Shqipëri, dhe se kush ishin familjet shqiptare që strehuan ata. Deri më tash, 22 mijë jo-hebrenj kanë marrë çmimin më të lartë nga Yad Vashem që nga viti 1963, në mesin e tyre, janë 63 janë kryesisht myslimanë nga Shqipëria.

Me këtë rast Liga Qytetare Shqiptaro Amerikane, ben realitet vendosjen e Shqiperise, ne seksionin e quajtur "Fisnike midis Kombeve" ne Muzeumin e Holokaustit ne ShBA. Tre Kongresmene hebrej, Gilman, Lantos dhe Nadler flasin ne ceremonine e sponsorizuar nga Liga si dhe ne receptionin perkujimor. Per here te pare ne mendjet e udheheqesve te hebrejo - amerikaneve arrihet te behet nje lidhje midis pastrimit etnik ne Kosove dhe genocidit te ushtruar ndaj hebrejeve gjate Luftes se Dytë Botërore. Për herë të parë duke i kërkuar udheheqesit komunist Ramiz Alia që tu bashkohej vendeve të tjera komuniste europiane ne heqjen e "perdes se hekurit" dhe hapjen e rruges drejt demokracise., Shqipëria e rrethuar nga telat me gjemba, shtypja e terrori i kuq, u "zbut" dhe tregojë se Shqipëria heq dorë nga rruga e izolimit gjysmë shekullor.

Në selinë e Kombeve të Bashkuara, më 29 janar 2008, pikërisht në Ditën Ndërkombëtare të Përkujtimit të Holokaustit, ku u hapë ekspozita që mban titullin: "Besa: Kodi i Nderit - Shqiptarët, që shpëtuan hebrenjtë gjatë Holokaustit", ekspozitë, që ka përkuar edhe me ditën e 60 - vjetorit, të Dekleratës Universale e të Drejtave të Njeriut, e pranuar më 1948, e ftuar nga organizatori i këtij përkujtimi mori pjesë edhe përfaqësuesi i familjes dibrane Besim Ndregjoni, nga Lukani - Peshkopi. Ekspozita koncoi edhe me ditën kur për herë të parë popujt anë e mbanë botës, pranuan konceptin "Dinjiteti dhe Drejtësia për të Gjithë njesojë",

Në një intervistë ekskluzive, i ndodhur në New York, Besim Ndregjoni, Sekretar i Përgjithshëm i Integritetit të Përndjekurve Politikë të Shqipërisë, sqaron dhe arsyen se erdhi në këtë ditë në New York. Ai thotë se unë kam ardhur në ditën ndërkombëtare të Kujtesës, këtu në selinë e O.K.B. i ftuar nga lobi hebrej dhe nga fotografi hebrej Norman Gershman, i cili ka hapur në ditën e kujtesës Ekspozitën "Besa", ku u ekspozuan fotografitë e shqiptarëve që kan mbrojtur hebrenjtë gjatë Luftës së Dytë Botërore. Vlerat e kombit tonë, u bënë të ditur botërisht këtu në selinë e O.K.B.-se Babi im Imer Ndergjoni, një luftëtarë kundër fashizmit që në vitin 1939, dhe një nacionalistë i shquar, mbrojtë një familje prej 7 vetash hebrej, sëbashku me xhaxhin tim Llan Destan Ndregjoni.

Kjo, familje e Hebreje ishte familja e Emunael Rubenit, që kishin në përbërje; gruan e tij Lea, si dhe vajzat Rashela, Rifka, Berta, Matilda dhe kunatin e tij Isak. Kjo, familje vinte nga Beogradi ku nazistët e

kishin masakrua njërin burrë të njëres prej vajzave. Ata ishin strehuar në Tiranë tek Isuf Zenuni aty këtë familje e mer babai im dhe pas tre ditë rrugë e strehon në Lukan, në shtëpinë e xhaxhait tim Llan Ndregjoni, ku kjo familje qëndroi që nga dhjetori i vitit 1943 - e deri në fundin e vitit 1945. Gjithashtu, kam ardhur dhe si Sekretar i Përgjithshëm i të Përndjekurve Politikë të Shqipërisë që në ditën e Kujtesës të bëjë prezent holokaustin komunist 45 vjeçarë, që familjet fisnike shqiptare kundërshtarë të diktaturës komuniste kaluan persekutimin më çnjerëzor të komunisteve. Fatëkeqesisht, akoma shumë institucione botërore nuk kan dijeni e duhur për këtë holokaust shqiptarësh, që pësuan familjet tona.

Unë do të ju jap një shëmbull midis mijërave familje shqiptare, vetëm familja ime që mbrojtë jetë hebrejsh dhe sot si këtu në New York, edhe në Paris, u nderuan për këtë vlerë humane, ata pësuan holokaustin



Foto nga ceremonia e dekorimit

komunist. Xhaxhai im Llan Ndregjoni u vra nga komunistët, Xhetan Ndregjoni, e Xhavit Ndregjoni, u vranë nga komunistët dhe Halil Ndregjoni vdiq në torturat çnjerëzore në hetusi nga komunistët, dhe Babai im Imer Ndregjoni u dënua dhjetra vite burg nga komunistët, e kur doli, ishte i sakatuar nga torturat çnjerëzore të krimit komunistë. Këta, u vranë se deshën jetën paqen dashurinë dhe se urrenin diktaturën e marrjes së jetëve njerëzore. Po si familja ime, në Shqipëri janë me mijëra e mijëra që edhe janë zhdukur nga kjo diktaturë. Prandaj bëra e ditur këtyre organizmave në këtë ditë nuk është një hakmarrje por një preventiv dhe drejtësi që popujt mos të njohin më Holokauste.

Lidhur me pyetjen se sa i ndjeshëm është komuniteti hebrej rreth asaj çka bënë shqiptarët, e çka vuajtën shqiptarët. A janë hapur rrugët për bashkëpunimin mes shqiptarëve dhe hebrejve, dhe pse u zgjodhë New Yorku, si vend takimi?

Zoti B. Ndregjoni, theksoi se: Hebrejtë kan një lidhje miqësore dhe njerëzore me shqiptarët, prej jo me pak se 2000 vjetësh sipas studjusve shqiptarë. Por, kjo veprimtari e orgnizuar këtu në O.K.B. nga vetë hebrejtë në ditën e holokaustit ishte jo vetëm një bashkëpunim i shkëlqyer në mes dy popujve, por dhe një vlersim që hebrejtë i bëjnë kombit shqiptar, për vlerat e shkëlqyer njerëzore që treguan në mbrotje të tyre. Vetë pjesmarrja e një sërë personalitetesh të këtij komuniteti, dhe ambasadorësh nga më se 50 vende nga më të rëndësishme të botës, në veprimtarinë e datës 29 janar, tregonte, se ata jo vetëm e duan popullin tim por dhe e respektojnë më shumë se të tjerët. U zgjodh New Yorku; se këtu ka një komunitet shqiptarë të madh, por edhe komunitet hebrej shumë të fuqishëm dhe shumë të madh.

Para, New York-ut, veprimtari analoge janë zhvilluar me komunitetin hebrej, edhe, në Paris, ku u mbajtën referate nga studijus shqiptarë e të huaj, si dhe u mbajtë edhe një meshë në Kishën e Roterdamit, për familjet tona që kishin mbrojtur hebrenjtë. Në selinë e OKB-së, e mori fjalën një izraelite, e cila foli në anglishtë: Sikur të paktën vetëm disa vende Europjane të kishin bërë çfarë Shqipëria bëri gjatë Luftës së Dytë Botërore, fati i popullit tim do të ishte krejt ndryshe .OKB-ja u bë selia e shqiptarëve për ditën e Kujtesës, dhe me kënaqësi u shpreh në emër të familjeve shqiptare, që mbrojtën jetë hebrejshë, me respektin për nderimin që u bë në këtë veprimtari.

GJIRI I VLORËS, LUGINA E DRINIT TË ZI DHE...

Nga ABDURAHIM ASHIKU

Me Vlorën jam takuar për herë të parë në korrikun e vitit 1955, kur sapo i kisha kaluar të katërmbëdhjetë vjetët e jetës. Shkolla ushtarake ku unë sapo kisha mbaruar klasën e shtatë e kish në program që të përcillte pushimet verore të skënderbegasve në Vlorë.

Atje, për herë të parë provova tallazet dhe ujën e kripur të detit. Dija të notoja. Kisha mësuar duke kaluar shkollat e Drinit të Zi një orë larg shtëpisë sime në fshatin e madh të Brezhdanit. Uji i detit, ndryshe nga ai i lumit, të mbante në sipërfaqet, kështu që kungujt e ujit, që i rrisnin kopshteve për të mbajtur ekuilibrin mbi ujë e për të mësuar notin, ishin tashmë të panevojshëm...

Provova edhe kandilat transparentë që të përcëllonin trupit atje ku ngjisin hifet e tyre.

Provova për herë të parë edhe një gjë tjetër, gjë e cila është bërë sebeb për këto shënime të largëta në kohë e hapësirë e që lidhen me Vlorën dhe Gjirin e saj, me Drinin e Zi dhe Dibrën mbarë, por edhe me të tjera probleme të ditëve tona.

Provova njollat e naftës dhe të vajit mbi trup, njolla që ishin më të vështira e të pështira se sa ato të kandilave të detit...

Plazhi aso kohe, i joni por edhe i qytetarëve, ishte në krah të djathtë të portit kur sheh detin, atje ku edhe atëherë edhe sot quhet "Plazhi i vjetër".

I madh, i gjerë, me rërë të virgjër...por me ujë ku pluskonin njolla naftë dhe vaji. Nga vinin ? Kush i hidhte ?

Vinin nga Uji i Ftohtë, siç quhej atëherë dhe siç quhet edhe sot. Një naftësjellës i kohës së mesit të viteve tridhjetë merre nga Kuçova naftën për ta përcjellë me benzinatat në drejtime të ndryshme ashtu si dekovili merre serën nga Selenica për ta përcjellë në të njëjtat rrugë. Teknika dhe teknologjia e ngarkimit të këtyre prodhimeve të tokës shqiptare i përshtateshin kohës. Ishte kjo arsyeja që bregu i bukur i Ujit të Ftohtë nuk ishte plazh, nuk frekuentohesh nga vlonjatet që e kishin në derë të shtëpisë, ashtu siç nuk frekuentohet (po bëj një kapërcim në kohë e hapësirë) bregdeti i Pireut apo ai i pjesës lindore të Salaminës, Megarës, Elefsinës, etj. në Greqi. Prania në brigjet e detit e ndotësve organikë dhe veçanërisht ata me burim naftë (veprim i ndërëgjegjshëm) ashtu si edhe prania e tyre në raste aksidentale (të pabërgjegjshme e të pandërgjegjshme) çon në shkatërrime ekologjike të cilët ushtrojnë një peshë të pa matshme mbi njerëzit dhe qeniet e gjalla.

Erdhi një kohë që Vlorës ia hoqën këtë "çiban". Lindi aso kohe Plazhi i Ri dhe ndërtimet e bukura për kohën, ndërtime që zunë vendin e kasolleve të ngritura me ngut nga mërgata çame...

Vlora është përsëri përballë një "çibani". Bregdetit të saj janë hedhë themelet e një kompleksi të madh naftë e gazi dhe të një strukture të gjerë termocentrale.

Vlora, në thelb, përjeton dilemat e ekzistencës së saj. Bukuria i jep asaj vlerat e një vendi turistik të shkallës së parë. Afërsia me brigjet e Italisë i jep asaj vlerat e vendit ekonomik të shkallës së parë në lidhjen me Italinë dhe me vendet e tjera të Evropës. Nga Vlora, që në kohën e pushtimit turk dhe të Ismail Qemali kalonte kablli telegrafik që lidhte Lindjen me Perëndimin. Prerja e tij nga anijet greke (siç kumtohet historikisht) në vitin 1912, preu edhe lidhjen e Lindjes me Perëndimin në këtë linjë komunikimi.

A duhet të kalojë linja e re e gazit dhe e naftës nëpër Vlorë drejt Italisë kur distanca tokësore midis këtyre dy pikave është më e shkurtra ? A duhet që Vlorës si alternativë të vetme t'i jepet që energjinë elektrike ta prodhojë në bregde-



Drini i Zi

tin e saj me termocentrale duke ia fshirë nga kujtesa projektet e ndërtimit të hidrocentraleve mbi lumin e Shushicës dhe të Vjosës ?

Por, në qoftë se gazsjellësi dhe naftësjellësi (apo gaz përcjellësi e naftë përcjellësi) do t'i hiqej Vlorës atëherë kujt do t'i jepej ?

Greqia, nëpërmjet Igumenicës, është gati ta marrë ashtu siç ka marrë edhe disa linja përcjellëse nëpër territorin e saj të naftës e gazit të ardhur nga Rusia nëpërmjet Bullgarisë dhe Turqisë.

Në Vlorë dilema hamletiane "Të jesh apo të mos jesh" (Ta bësh apo mos ta bësh) është shtruar në sofër.

Në fillim të shkrimit, në titull, por edhe në radhët e para, futa një paralele, futa Drinin e Zi dhe Dibrën. Nuk përmenda atë që e shndërron përfundimisht Drinin e Zi në një Liqen të Zi. Them "Liqen të Zi" pas liqenit të Fierzës ku bashkohet Drini i Zi me Drinin e Bardhë si dhe pas dy liqeneve të tjerë në territorin e Maqedonisë deri në Strugë, me ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës nuk ka më Drin të Zi. Madje, me ndërtimin edhe të hidrocentralit tjetër mbi Bushat të Shkodrës thuajse nuk ka më as Drin. Këtu nuk është fjala se shuhet një lumë për tu ngritur disa liqene, por fjala është se shuhet një krahinë e tërë, shuhet Dibra në tërë gjatësinë dhe gjerësinë e saj historike dhe ekonomike.

Për historianin Ali Hoxha, inicues dhe kryetar nderi i shoqatës "Për mbrojtjen e pronave dhe të mjedisit të pellgut të Drinit të Zi", në një dëshmi para ministrit Ruli "Dëmi ekonomik qëndron të plan të dytë në krahasim me dëmin historik dhe etnokulturor që i shkaktohet Kombit.

Duke ballafaquar rastin e Dibrës me atë të Vlorës ai thekson se, "...Vlonjatet kundërshtojnë ndërtimin e një TEC - i në krahinë e tyre, vetëm me pretekstin se ai u dëmtuaka atyre biznesin dhe turizmin. Krejt e kundërta ndodh me projektin e Skavicës. Këtu nuk bëhet fjalë për një "dëmtim" mjedisi, por me zhytjen përgjithmonë nën ujë të gjithë pellgut të Dibrës, më saktë zhdukjen e gjithë Dibrës dhe historisë së saj. Këtu nuk është fjala për cenim të pronës, por është fjala për zhdukjen e vendbanimit të një krahinë të tërë, për zhdukjen e kujtimeve historike dhe varreve të të parëve, të trashëgimisë kulturore, bile mijëra vjeçare, të rrënjëve etnokulturore të një krahinë të tërë."

Për të: "Në qoftë se shteti ka me të vërtetë interes kombëtar për ndërtimin e atij HEC - i, atëherë më parë duhet të ndërtojë një Dibër të re..."

Po ku do të ndërtohet "Dibra e re" ? Ai thotë se duhet të ndërtohet "diku ndërmjet Tiranës e Durrësit" ndërsa unë shtoj edhe bregdetin shqiptar (siç u

duan Dibrën është krim.

A ka zgjidhje që edhe Shqipëria të ketë dritë të bollshme edhe mjedisi i saj të jetë i pastër, edhe njerëzit e saj të mos detyrohen dhunshëm të ikin nga trojet e tyre.

Për Vlorën cituam projektin e njohur të ngritjes së hidrocentraleve mbi Vjosë e Shushicë për të shtuar edhe centrallet e erës dhe ato të diellit.

Për Dibrën do të desha që të nxirresh nga sirtarët e kohës së shkuar projekti për ndërtimin e hidrocentraleve të vegjël mbi kanalet ujitës, projekt i cili e ngjiste prodhimin e energjisë elektrike nga 16 milionë kilovat orë në vit (i mjaftueshëm për nivelin e kohës të harxhimit të energjisë për popullin dhe industrinë pa minierën e Bulqizës) në 220 milionë kilovat orë në vit energji, e mjaftueshme edhe për gatim e ngrohje të të gjithë trevës.

Sikur këtij studimi t'i shtoheshin hidrocentrallet e tjerë mbi degët e Drinit si ai mbi Zallin e Okshtunit, Murrën, Setën, Mallën, Veleshicën etj. atëherë tërësia e prodhimit të energjisë do të ishte më e madhe se ajo e Skavicës dhe furnizimi i hidrocentraleve të kaskadës së Drinit do të ishte në të njëjtat nivele prurjesh ujore.

Banorët e Kukësit me rezistencën që i bënë projektin për autostradën Durrës - Morinë, arritën t'i mbushin mendjen shtetit për devijimin e saj. Kjo u bë me dhimbjen e vonës gati njëvjeçare të ecurisë së punimeve...

Intelektualët e Shkodrës jo vetëm me rezistencën por edhe me intelektin e tyre arritën të argumentojnë se ndërtimi i hidrocentralit në Bushat do të shkaktonte dëme të mëdha ekologjike për zonën. Ata, megjithatë nuk e lan zonën e tyre pa një hidrocentral të ri, por jo në Bushat, diku sipër tij, atje ku harmonizohet më mirë e sotmja me të ardhmen...

Ndoshta autostrada Tepelenë - Levan do të ishte në mes të punimeve sikur politika të mos kishte këmbëngulur me kryeneçësi për ndryshimin drastik të linjës së saj...

Ndoshta edhe gratë e "Autostradës Ballkanike" në Vlorë nuk do të ishin futur në grevë urie sikur shteti t'i shpërblente në mënyrë dinjitoze për dëmet që u shkaktoheshin nga shkatërrimi i pronës.

Në Vlorë kërkohet me këmbëngulje referendum për ndërtimin ose jo të kompleksit energjetik dhe të petroliferës...

Në Dibër, nesër, kur buldozerët e firmës së huaj do të nisin ndërtimin e digës së Skavicës... me siguri do të kërkohet një referendum miratimi ose jo të mbyrtjes së trevës...

Në rrethinat e Tiranës ku thuhet se është zbuluar në thellësi të mëdha një sasi e tillë gazi e naftë që do ta shndërronte vendin në një Kuvajt...me siguri nesër do të kërkohet referendum lidhur ekologjinë e zonës...

Në... Kërkesa për referendum bëhet atje ku shteti nuk pyet...

Referendumi është një e drejtë e mi-letit që rrjedh nga padrejtësia dhe paaftësia e shtetit...

FTESË PËR BASHKËPUNIM

Gazeta "Rruga e Arbërit" është e hapur për çdo lloj bashkëpunimi. Të Interesuarit mund të sjellin opinionet e tyre për çështje e probleme të ndryshme që shqetësojnë Dibrën e dibranët. Redaksia mbetet e hapur për çdo lloj bashkëpunimi, me synimin e vetëm: përhapjen e së vërtetës dhe mendimit progresist. Redaksia kujton bashkëpunëtorët se dorëshkrimet janë të pakthyeshme dhe jo çdo shkrim mund të botohet. Tel:068 31 19 232. Tel: (04) 357 179 / 233 283 Email: lid_gazeta@yahoo.com



Nga Agron TUFA

Ishte një respekt prekës. Drejtori i Festivalit të poezisë kishte dalë të na priste nga Korça dhe na gjeti në një kafe buzë liqenit të Pogradecit. Ende pa u ngritur nga tavolina, Drejtori pagoi kafet, doli bashkë me ne, bëri nga makina e vet ngjyrë vishnje, hapi derën dhe ende pa u ulur në sendilje dikush e pyeti:

- Për ku, Drejtor?
- Po ndë Torçë bre! Ndiqni makinën time... Do ndaloni para Pallatit të Punëtorëve.

Mbrëmja që e lagësht nga shirat e ditëve të para të majit dhe era që frynte nga Morava atij muzgu, na shtiu mornicat në shtat. Nën dritën e zbehtë të hollit na përshëndetën dy botues ezmerë, hundëkrutë e çehrevrarë me fytyra si derdhura në kalk.

Salla e ngrënies, nën një çorbë muzikore shqiptaro-jevgreke gumëzhinte si fushatë të mbjellash nga mizëria e poetëve, shumicën e të cilëve ose nuk i njihja, ose i kisha parë tek-tuk, kalimthi, në kohë të ndryshme nëpër promovime librash, kryesisht me fytyra të rrudhosura, flokë gjysmë të rëna e të thinjura, sy të flashkët e faqe të rruftura. Qenë veshur thuasë njëloj të gjithë: xhaketa të vjetra ose kostume teritali të viteve shtatëdhjetë, porse ndjeheshin shend

Sekrete të mëdha poetësh

e gazmend, mbaheshin me të madh, duke u përsjellë rredh dieje të tyre – ndoca dama në mesmoshë, që dalloheshin nga tualeti i rënduar, tushi i lyrshëm në qerpikë, buzëkuqi ngjyrë tulle dhe përgjithësisht – shajet e hollë, të lidhura me një nazikë të përkushtuar. Tek-tuk, në banketin e madh, shquheshin si qershiza të kuqe vend një torte të pudrosur me kakao e vanilje – poeteshat e njoma, shtat-nimfa, me faqet që u kuqëlonin purpur prej ngacmimeve çapraze dhe fjalëve fluturake që hidhnin andej-këtej ustallarët e rreshkur të poezisë. Kryet e banketit e zinte një damë e provokuese: ajo u lexonte vargje nga libri i saj i famshëm "Njëqind e një fjalë të ndyra dashurie" dhe, përreth e përqark, shushurinte një blegërimë e paqtë gazmore me të qeshurat e poetëve.

Sado u përpoqa të zë një vend pa u vënë re, në përfundim të ushqimit të ftohtë, përleshje pjetave që rritur tashmë një parg i madh vëllimesh poetike me autografe. U ngjita në numrin tim tamam në kohë, sapo filloi të gjëmojë një ortek i fortë tingujsh grekë dhe në pistë u derdh rrekeja e parë me kërcimtarë-poetë. Ishte një muzikë pub-esh.

Të nesërmen heret, në sallën ende të boshatisur ku sapo kisha ngrënë mëngjesin, rreth tavolinës sime po sillej me drojë dhe i pavendosur B. Shaqiri, një poet që e mbaja mend falë një vëllimi simpatik me titullin e çuditshëm: "Poet, a do nuse?"

- Uluni, - i thashë.
- A mund të ulem? – pyeti për t'u siguruar, ndërkohë që u avit dhe kamarieri.
- Sigurisht. Çfarë dëshironi?
- Mund të marr çfarë të dua?
- Sigurisht.
- Atëherë... u mendua ai, duke parë i lëkundur herë nga unë, herë nga kamarieri, - Një kafe, dhe... një lëng vishnje.

Kamarieri mori të largohet, por B. Shaqiri, i thirri i emocionuar:
- Po lëng bananie, kenë?
- Ka, - tha kamarieri.

- Edhe një lëng bananie, - tha i kënaqur B. Shaqiri.

I zgjata një cigare, por B. Shaqiri nuk e pinte. Erdhën porosinë. Gjatë gjithë kohës nuk foli. Pas çdo rruftije të kafese, thithte me pipëz me radhë nga një gëllënjë lëng qershie dhe bananie. Befas më tundi fort krahu dhe më zë të ulët e konfidencial:

- Shihe, shihe... atë që shkau si mi përgjatë banakut, - tha, duke parë më ca sy të llamburitur nga ironia.

- Kë more, për kë e ke fjalën?
- Atë pra, atë picirrukun si mi me push... medemek, mbretin e hajkut shqiptar!

- Aha, - reagovala, pasi e njoha. – Pse, a nuk është menjëmend mbreti i hajkut ai?
- Shiko, - tha B. Shaqiri, me një pamje të thellë e të menduar. – Atë e gënjen mendja se shkruan hajku. Hajku, more mik, nuk shkruhet në gjuhë tjetër, përveçse në japonisht. Në shqip nuk ka hajku. E atë e gënjen mendja...

- Ke të drejtë, - i thashë. Në Shqip nuk ka hajku.
- Tashi, prit... ta themi mes nesh, - tha ai, duke mu afruar rrëzë veshi. – Edhe në shqip ekziston hajku. A të ta them? Dhe sikur të më besonte një sekret të rrallë pëshpëriti me një zë akoma më të ulët dhe me një shprehje gati të frikshme, mistike:

- Hajku ekziston në Lushnje!
- Ashtu?! - u habita unë.
- Mos i thuaj kujt! - tha B. Shaqiri. – Kam eksperimentuar unë. E di, janë ca trevargësha këngësh popullore... unë i kam përpunuar... dhe ky është hajku shqiptar.

- Po si ia dole? – e cyta.
- Shiko, - tha, duke më tundur krahu. – Ka një problem. Prapëseprapë, ato vargje nuk mund t'i quash hajku. Është çështje emërimi, kupton?
- Ke të drejtë, problem i madh... - i thashë.

- Mirëpo unë edhe këtë e kam gjetur! - i shndrinë sytë B. Shaqiri.
- Ti po më habit! – i thashë, duke

ndjerë se kisha rënë padashje në intonacionin e zërit të tij. - Edhe këtë e ke gjetur?

- Po ore! Veçse është sekret! – tha duke ngritur të dyja pëllëmbët lart.

- Epo, sekreti është sekret, s'ke ç'i thua, - pranova, duke refuzuar të di më tej.

- Po sikur ta them, ti di ta ruash sekretin?

- Ej, lere më mirë. S'je i detyruar ta thuash...

- Çfarë?
- Sekretin pra. Emërtimin e trevargëshit... të hajkut në shqip.

- Po. E kam gjetur si ta quaj, - i shndrinë sytë B. Shaqiri. – Ja po ta them, - tha, dhe pa rreth e rrotull me diniakëri, mandej mu avit me kupat e pëllëmbëve hinke tek goja, m'u rrëzë vëshit tim.

Ishte vetëm një shushurimë ajri. Ndërsa unë kisha mbetur ende i sforcuar, me kokën e anur andej nga më kishte pëshpëritur, B. Shaqiri vetë, kishte zënë tashmë vend në karrige dhe më shihte me sytë shpuzë, duke pritur efektin.

- Më fal, por nuk e dëgjova mirë, - i thashë.

- Çfarë s'dëgjove mirë?
- Atë se si i quaje ti ato trevargëshat lushnjarë.


Ashtu si herën e parë, me pëllëmbët te goja, B. Shaqiri u avit sërish dhe më pëshpëriti fort rrëzë veshi:

- Shaqirka!
- Shaqirka?

- Po, po, Shaqirka i kam quajtur. Kështu do të hyjnë në historinë e letërsisë shqipe. Të pëlqen? – tha i shqetësuar kur pa se në sallë vërshoi një grup i madh poetësh që dukeshin nga pamja dhe nga veshja binjakë të tij.

- Gjeniale! – i thashë.
- Asnjë fjalë për këtë, se po e morën vesh këta, - tha duke anuar me kokë nga poetët që po mbushnin sallën, - më vjedhin idenë!

- Të betohem! - i thashë, para se dy poetë të tjerë të mbërrinin aty, bashkë me karriget që tërhoqën nga tavolina fqinje.



Abdurahim Ashiku.
"Njerëz që i dua", publicistikë
Botimet "m&b". ISBN 978-99956-04-08-0
Çmimi: 700 lekë

"Dashuria është më e fortë se urrejtja. Urrëjtja shkatërron, kurse dashuria ndërton, prandaj ajo është më e fortë" - është një thënie e P. Abrahams, që të vjen vetvetiu në mendje, sapo mbaron së lexuari librin me publicistikë të Abdurahim Ashikut.

Shumëkush prej lexuesve, ashtu si unë, e kujtojnë gazetarin dibran që ka dhënë dhe jep një kontribut të madh në shtypin e shkruar. Ai punoi në Dibër, në një terren të vështirë të përcjelljes së informacionit dhe mendimit kritik. Ai ishte korrekt me lajmin dhe i qartë në opinion, por realiteti që e rrethonte ishte mbyllës e kërcënues. Kështu, 12 vite të shkuara, u detyrua të largohet në Athinë, jo si shumë emigrantë të tjerë për bukën e gojës, por që të shpë-

Rilindja e Abdurahim Ashikut

tonte nga realiteti që e rrethonte, për t'i shpëtuar urrejtjes e smirës, të cilat nuk kishin lënë vend për dashuri në atdheun e tij.

Por fati e takon me një taksist "alvanos", i cili i thotë: "Na jeshëm skipëtarë një qind për qind, po greku na thithi. Nuk na la të vazhdonim skolinë dhe nuk mundëm me mësuë dhe me shkruë gluhën tënë. Edhe juve kështu do t'ju ndodhë. Fëmijët tuej nuk e mësojnë gluhën e mëmës, nuk kanë disirë të këthenenë në Skipëri, do bënenë grekër si na...". Dhe kjo këshillë e këtij "shqiptari" 100% i tregojnë Abdurahimit brengën, shqetësimin dhe mallin për familjen e tij e për Shqipërinë...

Që nga ajo ditë "një flamur të vogël kuq e zi e mban te koka e krevatit".

Duro do t'i përkushtohej veprimtarisë publicistike. Në shtypin e shkruar për emigrantët, në Shqipëri dhe në Athinë, ai do të shkruajë për dhjetëra e qindra emigrantë, për hallet e tyre, problemet, sukseset, vështirësitë, gëzimet, dashuritë, pasionet, jetën e përditshme, ëndrrat, dëshirat, mirësitë, duke u ushqyer atyre dashurinë për njerëzit dhe për atdheun. I takon në kafe, u shkruan e-maile, flet në telefon, u kujton vendlindjen, malet, fushat... U shkruan me pasion e dashuri, sikur të ishin fëmijët e tij...

Ai i merr emigrantët dhe i çon larg, shumë larg në vendlindjen e tyre. I ngjitet në Bogë, në ato pllaja të mrekullueshme ku vetëm një here ka qenë në jetën e tij, pastaj i çon më larg, në luginën e Valbonës, duke i nanuritur me shkumëzimin e atij uji të kthjelltë e të ftohtë. I ngjitet grykave të ngushta, i fut në Shpellën e Dragobisë dhe i ngrin bashkë me krushqit e legjendës në një pllajë malore të Bjeshkëve të Namura ku Zanat, Muji dhe Halili kanë bërë rrënjë në legjendën e

madhe shqiptare. Më tej i zbrat butë-butë, si të shkel në një shilte mbushur me lesh deleje rude, fushës së bukur të Kosovës... Pastaj i ngjitet në Korab, në zemër të tij, atje ku ujërat e dëborës shkrijnë në burime të ftohta, mbliqen e humbasin midis shkëmbinjve për të dalë diku në bjeshkët e Radmirës, duke formuar Veleshicën ujëpastër. Ngjitet në Gramë, në Bjeshkën e Zonjave, merr me vete blegërimat e deleve dhe qengjave, fluturon mbi Drin e ndalet në malet e Lurës, në Gjagjisht e Runjë, për të pirë ujë kroveje e për t'u çlodhur me pamjen e zambakëve të Liqenit të Luleve në sy. Pastaj, si manar, u ngjitet maleve dhe bjeshkëve të Jugut. Udhëton maleve të Skraparit, të Qafë - Devrisë, të Gjerbësit, Melovës e Rehovës, që në sy kanë Tomorrit e lashtë dhe malet e Korçës e të Pogradecit, tutje pyllit të majave shkëmbore. Ngjitet edhe në Kuç, Kallarat, Bolënë e Tërbaç, luginës së bukur të Shushicës. Ulet në breg të liqenit të Pogradecit e brend fushës së Korçës, asaj treve që ka ngjizë në shpirtin e të riut dhe plakat gëzimin që sjell melodia e kitarës...

Në mënyrën e të shkruarit të Abdurahim Ashikut vihet re një rilindje e tij. Ashtu si rilindësit tanë që krenoheshin me bukuritë e Shqipërisë dhe, nëpërmjet saj, u bënin thirrje shqiptarëve të punonin e kontribuonin për vendin e tyre, edhe ai kërkoi të bëjë të njëjtën gjë, duke u rritur emigrantëve dashurinë për atdheun dhe gjuhën shqipe...

Kur e takova para pak kohësh, kishte ardhur në një seminar që organizohej me mësuesit e gjuhës shqipe në botë, mes të cilëve ishte dhe ai. Duro filloi të më tregonte për jetën e tij të re në Athinë, për punën, familjen, gazetarinë, për bashkëpunimin e tij me gazetën "Emigranti",

por më shumë më foli për "profesionin" e ri të të mësuarit të ABC-së fëmijëve të emigrantëve. Vështirësitë, problemet, pengesat... Ato çaste m'u duk një Rilindas i shekullit të ri...

Në këtë libër gjithë "dashuria" e tij nuk njih diferenca në të shkruar. Me të njëjtën dashuri ai ka shkruar për artistin, doktorin, shkencëtarin, emigrantin, qytetarin grek...

Në faqet e këtij libri përshkruhen me dashuri Vangjeli, shoku grek i klasës në shkollën e mesme, Kureasi, Fiqreti, Agroni, Alketa, Foto, Kesnofoni, Brunilda, Ana, Vasilika, Vojsava, Englantina, Afrimi, Aleks, Eqeremi, Lindita, Fehmiu, Grigori, Kastrioti, Jorgji, Lefteri, Mario, Novruzi, Panajoti, Ramazani, Gjergji, Kola, Mondri, Durimi, Nikolla, Lulëzimi, Alekoja, Levisi, Serafina, ashtu si dhe portretet e intervistat e personaliteteve si Kadri Roshi, Dritëro Agolli, Afrim Agalliu, Muhamet Liko, Agron Hamo, Sabri Fejzullahu, Cekes e shumë e shumë të tjerëve...

Të gjithë këto personazhe i bashkon në librin e Duros ndjenja njerëzore e dashurisë, mirësisë dhe respekti për njerëzit e Atdheun.

Ai kujton me një dëshmi edhe Fitimin, Pirron, Ilmiun, si dhimbje të tranzicionit të vështirë shqiptar... Dhimbje të cilën Duro e jep të gjallë te çdo fytyrë nëne, gruaje, motre, te çdo tregim i kësaj përmbledhje publicistike.

Kur mbaron së lexuari librin, çdonjëri prej nesh zbulon një dimension të ri të jetës: dashurinë për njeriun, atë dashuri që Abdurahimin e ka shndërruar në një Rilindas Modern.

"Ata që dashurojnë deri në fund, nuk plaken kurrë - thotë B. Franklin. Ata mund të vdesin nga pleqëria, por vdesin të rinj".
Bujar Karoshi

NËNQIELLI YNË I KA RRËNJËT E THELLA

Veshtrim recensiv i librit të Sabit Bockut, Oraniku-Sheri i Dibrës

Nga NURI KOLECI

Për lexuesin shqiptar, e në theks të veçantë atë dibran na vjen një befasia e këndshme e librit "Oraniku-Sheri i Dibrës" si rezultat i një pune të palodhshme të Sabit Bockut i cili këtij nënqielli i dhuron një studim serioz monografik me peshë të veçantë për historiografinë shqiptare.

Autori me plot përkushtim i është qasur këtij libri duke shfrytëzuar një material burimor, të pasur dhe të shumëllojshëm. Njëherit ai ka shfrytëzuar me kujdes të veçantë dëshmitarë të gjallë qysh para 20-30 viteve, të cilët duke qenë bartës të spjegimeve që paraardhësit e tyre i kanë përcjellur nëpër breza.

Duke mos dashur që të hyjmë në shembujt e marrur të mikrotoponimeve që spjegohen në kwtw libër, shpalosen dhe sqarohen me të vetmin qëllim që të mos shuajmë kureshtjen e lexuesit të nderuar, nuk do të merremi me citime, por thjesht do të paraqesim një zbërthim të shkurtër e të saktë për vlerën e këtij libri, të sapo dalur në dritë.

Autori me metodologjinë e punës është mbështetur në dy shtyllat kryesore të historiografisë, edhe atë në faktografi dhe në metodologji të punës.

Etnogjeneza e jonë ilire korrespondon drejtëpërsëdrejti me mikrotoponimet ku autori jo vetëm që u jep etimologjinë, por njëherit ai i rikujton lexuesit me repertoarin e begatshëm të këtyre emërtimeve.

Duke dashur që të shpalosim librin në tërësi nuk duhet që të injorojmë faktin se trashëgimia në tërësi të të gjithë popujt luan rol tejet relevant në ruajtjen e gjenit, historisë dhe në ndërtimin e ardhmërisë. Kështu brenda mundësive

stërgjyshërit tanë gojarisht e rallëherë me shkrim na lanë për trashëgim një të kaluar për të cilën sigurisht që krenohemi dhe na jepet mundësia që ta identifikojmë veten me një të kaluar të begatshme.

Vetë dinamizmi i jetës, pikërisht tani më që jemi në shekullin e kompjuterëve, nuk na siguron një trashëgimi gojore e cila ka për tu bartur si dikur brez pas brezi. Ndaj, libri të cilin e promovuam kwtw ditë, ka për të mbetur një garancion dhe piknisje e qëndrueshme e bartjes së një të kaluarë për breznitë e ardhshme. Pra, autori Bocku, me një përkushtim tejet serioz i është rrekur kësaj pune madhore sa të mundishme aq edhe tërheqëse, sa domethënëse aq edhe të vlefshme. Themi kështu sepse autori na dhuron një spektër tejet të gjërë për toponimet dhe mikrotoponimet në Dibrë të Madhe dhe rrethinën e saj duke inkluduar këtu edhe komunën e Qendrës së Zhupës.

Gjatëkohë nëpër histori, ata që erdhën në trojet tona, përpos peripetive tjera me plot reprekusione, arsyetoheshin njëherit se ne nuk jemi autoktonë në këto troje dhe trajtoheshim dhe po trajtohemi nga disa qarqe albanofobe si ardhacakë. Kuptohet, të gjithë pushtuesit pikësynim kryesor kanë pasur, përpos tjerash t'i ndryshojnë emërtimet e viseve tona me të vetmin qëllim që të arsyetojnë aspiratat e tyre gllabëruese. Kështu ata arritën shumë makrotoponime t'i ndryshojnë duke sajuar e ndryshuar zanoret e emërtimeve, duke u shërbyer me parashitesa e prapashitesa, me teza pseudoshkencore. Sado që të kenë zgjatur okupimet, atyreve nuk u ka mjaftuar koha që t'i ndryshojnë të gjithë mikrotoponimet e trevave tona. Ndaj ne si shqiptarë nuk kemi nevojë të falsifikojmë

historinë. Faktografia është e pranishme kudo që të hudhim shikimet tona.

Pikërisht këtu qëndron një argument tejet i fortë se mikrotoponimet luajnë rol qënësor në dëshminë e autoktonitetit tonë. Dhe... nuk është e rastit që autori është marrur pikërisht me etimologjinë dhe spjegimin e mikrotoponimeve. Mikrotoponimet, pjesa dërmuese e tyre, e kanë të drejtën historike me një mbështetje të shëndoshë etimologjike, semantike dhe gjuhësore që njëkohësisht dëshmojnë një të kaluar të pakontestueshme që shlyen gjasat e manipulimeve për interesa thjesht të njohura deri më tani.

Poqese e shfletojmë këtë libër do të vërejmë se në sqarimin e emërtimeve dominon një korrektësi reale qoftë duke u shërbyer me një bibliografi tejet të pasur, qoftë duke u shërbyer me bisedat që ka zhvilluar autori me njerëz të moshuar vite të tëra më parë, dhe në këtë mënyrë pamundësohet që të njëjtit t'i shkel koha, t'i mbulojë pluhuri i pamëshirshëm i saj.

Ky libër tregon dhe dëshmon, në kornizë të faktografisë se edhe këtu në nënqiellin tonë, rrënjët e autoktonisë janë tejet të thella dhe askush s'do të mundet t'i shkulë të njëjtat. Themi kështu sepse shembujt e marrur në këtë libër janë tejet bindës dhe shkencërisht të vërtetuar.

Puna e palodhshme dhe e gjatë e autorit është një retencion edhe për ne që jemi tani më në moshë, sepse duke na përkujtuar disa mikrotoponime që nuk i kemi dëgjuar fare apo disa të tjerë që i kemi lënë në harrësë na ringjallin një të vërtetë të kaluar dhe të pamohueshme. Do të hasim aty, emra fshatrash të braktisur, lagjesh të qytetit tani më të braktisura, emërtime fushash, çeshmash, ara, livadhe, përenj, rrugë,

kodra etj. të cilët sikur të kishin gojë do të flisnin për stërlashtësinë tonë të pamohueshme.

Ky libër përpos tjerash, inicon duke nxitur gjeneratat që vinë pas nesh të kenë një udhërfytyrë tejet të qartë në analizë edhe më të tutjeshme, ndoshta edhe më shkencore, me të vetmin qëllim që të mos lejojmë që të na i shtrembërojnë faktet e të mos na mohojnë një të vërtetë që na përkjet vetëm ne.

Duke shëtitur nëpër libër do të vërejmë se autori me plot argumente përmbyb përpjekjet e fantazive qesharake të ardhacakëve që viset tona të kenë emërtime me etimologji slave.

Ndërmjet rreshtave të librit lexuesi do të ketë mundësi që të haset në mohime tejet të argumentuara ku politika gllabëruese sllave të rrënohet me plot bindje dhe njëherë e përgjithmonë t'i jepet fund manipulimit qesharak dhe pseudoshkencor.

Shëtitja e autorit nëpër distancë kohe nëpër mikrotoponimet e nënqiellit tonë është përforcuar edhe më tepër me gjuhën tejet modeste dhe konkrete, me një gjuhë të përkapshme për të gjithë llojet e lexuesve, me gjuhë të pastër shqipe dhe mbi të gjitha, gjuhë që flet nëpërmjet argumenteve dhe stilit sa të vlefshëm në aspektin liguistik aq të vlefshëm edhe në atë shkencor.

Për përfundim do të theksojmë se ky libër nuk është përshkrim i rëndomtë i gjërave në formë narracioni, por ai paraqet një dëshmi të gjallë aq të ngjeshur që kurrë s'mund të shkatërohet. Pra në repertoarin e librave të botuar në Dibrë të Madhe, jemi të dhuruar me një perlë sa historike aq edhe gjuhësore e cila ka për të shërbyer për hulumtime edhe më të thella në botën e realitetit tonë të paluhatshtëm.

Radioamatorizmi Shqiptar mbushi 55 vjeç

(25 vjet nën drejtimin e Miftar Fanës)

Më datën 13 janar në një nga sallat e Shtëpisë Qendrore të Ushtrisë u festua gjithë madhështi 55 vjetori i Federatës së Radioamatorizmit Shqiptar. Salla ishte mbushur me sportistë dhe sportdashës, intelektualë dhe njerëz të mediave. Ishte një mjeshtër festiv që sporti shqiptar rrallëherë kishte festuar. 55 vjet nuk i thonë pak për një sport që ende tek ne përsëri pak njohuri kanë njerëzit. Megjithatë, udha e kësaj federate është shumë e gjatë. Ajo nisi më 22 dhjetor 1952 nën kujdesin direkt të gjeneral Spiro Moisiut, si domosdoshmëri për strukturat e mbrojtjes si dhe Ministrisë së Brendshme dhe kundërbulimit. Ishte rastësi që pikërisht në këtë tubim festiv do të informoheshin qartë se këtë Federatë për më shumë se njëzet e pesë vjet e drejtonte miku dhe bashkëfshatari im, intelektual i kompletuar i Dibrës, ushtaraku me përvojë Miftar Fana. Jo vetëm unë, por dhe shumë miq e kolegë të mi nuk dinin se ishte pikërisht Miftar Fana ai që drejtonte për 25 vjet sportin tashmë aq të përhapur në të gjithë botën, Federatën e Radioamatorizmit Shqiptar. Miftari ka lindur në Shumbat në një familje me tradita atdhetare, ku tipar kryesor kjo familje ka pasur besën, bujarinë dhe inteligjencën e lindur. E vetë Miftari ka përfutur shumë nga të parët e tij. Shkollën fillore e mbaroi në vendlindje, duke qenë dhe një nga nxënësit e

parë, pasi pikërisht në atë vit që u regjistrua u hap dhe shkolla në fshat. Ishte nxënësi i shkëlqyer dhe tepër i rregullt, tipar ky që e ka karakterizuar gjatë gjithë jetës.

Pas një pune të gjatë dhe të lodhshme për moshën që kishte atëherë në Peshkopi, në ndërmarrjen e telekomunikacionit, Miftari përfitoi shumë nga kjo përvojë pune dhe mëson profesionin e radio-telegrafistit. Dëshira e madhe për dije bën që Miftari të largohet nga vendlindja dhe t'i përkushtohet arsimimit të tij. Pas përfundimit të shkollës së lartë të oficerëve inkuadrohet në repartet ushtarake. Në fillim si oficer i thjeshtë, por më vonë edhe pranë shtabit të përgjithshëm me gjeneral Petrit Dumen, ku ende ruan kujtime të bukura. Punoit dhe pranë ministrit të Mbrojtjes si shef i radios. Për gati 12 vjet me radhë ka qenë pedagog në Akademinë Ushtarake në Katedrën e Ndërlidhjes.

Në kohën që doli në pension ishte shef i Shtabit të Ndërlidhjes. Miftar Fana, një intelektual i kompletuar dhe kuadër i aftë ushtarak, fitoi edhe një përvojë mjaft të pasur në profesionin e radioamatorizmit. Duke parë pikërisht këtë përvojë të gjatë profesionale dhe aftësitë e tij, kjo Federatë para 25 vjetësh e zgjodhi Miftar Fanën President të saj, post që po e mban ende. 25 vjet nuk i thonë pak që të drejtosh një sport që ende ka enigmat e tij. E pikërisht

ishte në 55 vjetorin e lindjes së kësaj Federate, ishte pikërisht Miftar Fana ai që përshëndeti veteranët e këtij sporti dhe u zotua në emër të saj për arritje dhe rezultate nga më të rinjtë. "Suksesin ia dedikoj punës së gjatë në ushtri, pasi rregull dhe disiplinë ushtarake kalitin ndërgjegjen e të gjithëve për vështirësi edhe më të mëdha – u shpreh zoti Fana. Por profesioni im i ndërlidhjes, duke u bërë profesionist qysh në moshë të re më ndihmuan shumë edhe në sportin e radioamatorizmit, pasi ky lloj sporti është i lidhur shumë me ndërlidhjen, pasi në kohë e situata të ndryshme i shërben shumë kësaj. Sot Federata e Radioamatorizmit Shqiptar ka arritur vërtet rezultate dhe kjo nuk ka ndodhur vetëm në saj të punës time. Edhe kolegët e mi që kam punuar prej vitesh kanë qenë dhe do të mbeten vërtet një përvojë e pasur jo vetëm për mua, por për gjithë Federatën. Sot kjo Federatë është shtrirë në të gjitha rrethet e vendit ku kemi vërtet ekipe me ambicie që kanë premtuar dhe kanë arritur rezultate në punën e tyre".

Radioamatorizmi është një sport vërtet i vështirë. Ky nuk mund të klasifikohet si sportet e tjera si p.sh mundja, ku mund të klasifikohet edhe si lojëra popullore. Radioamatorizmi është i vetmi sport që këtu duhet përgatitje jo fizike, por mendore. Federata e Radioamatorizmit Shqiptar ka 55 vjetorin. Të vjetrit janë bërë veteranë



Miftar Fana me Presidentin e Komitetit Olimpik Shqiptar

dhe një plejadë e re ka zënë vendin e tyre.

"Më shumë elementët e përshatshëm i gjejmë tek shkollat e mesme, - thotë Miftari. Kështu kemi vepruar në çdo rreth dhe ndaj edhe kemi pasur rezultate. Të rinjtë janë më të dhënë nga ky lloj sporti dhe bëhen më shpejt profesionistë. Pas viteve nëntëdhjetë numëroreshin 1250 radioamatorë të kategorisë së parë, të grupuar në klubet sportive Tiranë, Peshkopi, Kukës, Shkodër, Elbasan, Korçë, Vlorë, Gjirokastrë. Janë edhe 670 radioamatorë të kategorisë së dytë në Tropojë, Pukë, Laç, Rrëshen, Librazhd, Ersekë, Sarandë, Delvinë, Tepelenë e Përmet.

Radioamatorët i kanë zhvilluar garat çdo vit në salla të mbyllura. Sot vetëm nga Federata e Radioamatorizmit Shqiptar ka 21 mjeshtër sporti dhe 12 mjeshtër të merituar. Ekipi i meshkujve u kthye me medalje nga Amsterdamin i Holandës

në takimin dy e shumë palësh. Duhet përmendur se ekipi i "Partizanit" dhe ai "Elbasanit" kanë dalë të parët jo vetëm në garat kombëtare, por dhe ato ndërkombëtare.

Në vitin 1992 ekipi i vajzave zuri vendin e dytë në Budapest të Hungarisë midis ekipeve të Europës. Ekipi i djemve me Fatos Demetin u kthye nga Amsterdamin i Holandës me shumë medalje. Arritjet dhe rezultatet që sot ka Federata e Radioamatorizmit Shqiptar janë edhe në sajë të partnerëve ndërkombëtarë si në Hungari, Rusi, Itali e Suedi. Edhe në 55 vjetorin e lindjes së Radioamatorizmit Shqiptar, radioamatorët u zotuan se do ta ngrënë lart e më lart emrin e Shqipërisë kudo nëpër botë, ku do të ketë gara dhe këtë betim e bënë me gjuhën e bilbilit, që radioamatorët komunikojnë mes tyre kudo brenda dhe jashtë vendit.

Shaqir Skarra

VISARE NGA ODA DIBRANE / FJALË NË SEPETE



Nga NAIM PLAKU

Puno Gjoka e ha Luca



Thonë se Gjoka dhe Luca kishin qenë vëllezër nga baba dhe jetonin për bukuri në katundin Lug, që aso kohe ishte qepur si një fole dallëndysheje në shpatullën lindore që binte thikë mbi Drin, pak para se ky të përqafohej, ashtu si sot me të çmendurën Veleshicë, që i përplas pa pra gurë e baltë në gjoksin e tij të hijshëm.

Sa ishin fëmijë duheshin aq shumë me njëri-tjetrin, sa që edhe plakati e fshatit u binin syve¹ e thoshin "marshalla", kur i shikonin këta vëllezër akranë², të hijshëm e të shëndetshëm si dy topa bore, gjithmonë bashkë, dorë për dorë, duke ruajtur shqerrat e duke bërë sa e sa punë shtëpie. Kishin lindur të dy në pranverë, njëri në mars e tjetri në maj, këtu e dhjetë vite më parë. Kështu ishin ata, vëllezër nga nëna, se Lami, baba i tyre, ishte martuar dy herë. Kishte dy gra, Soricën e Lushën³, që vërtet ishin të bukura e punëtore, por ama ishin barut që i vinin flakën shtëpisë, haheshin e grindeshin me njëra-tjetrën, aman, o Zot, mos ndodhsh afër tyre, kur nxirrnin gjithë ato fjalë të shëmtuara nga goja për pesë para spec. I kishin parë edhe më keq, duke u kapur flokë për flokë të gërvishitura e të gjakosura hukubet?⁴, e ndaheshin paq vetëm kur ndërhynte Lami me një shkop të rëndë thane, gjersa t'i bënte postel?⁵. Atëherë shkonin secila në odë të vet, flisnin me vete gjer në mesnatë dhe pajtoheshin vetëm pas një jave, kur ndërronte vathë Lami⁶.

Më vonë punët filluan të duken pa shoshë?⁷. Lami vdiq, kur fëmijët ishin akoma të vegjël. Vërtet i la me tokë boll e me gjë të gjallë, me arë e vathë, siç i thonë, por shtëpia e Lamit u bë më vonë si ai lisi, që andej nga i bije dielli i zgjat më shumë degët. Kështu dhe dy gratë e veja nuk pritën gjatë, por sa mbylli sytë i zoti i shtëpisë, i ndanë sinorët dhe secila filloi të ngrohet në kolirin e vet?⁸. Gjoka kishte dhe një vëlla e dy motra të një nëne e babe, ndërse Luca ishte i vetëm, prandaj u rrit ndryshe. Si djalë përmallë që ishte për Soricën, u rrit me përkujdesje të veçantë, si kokla në dhjamë. Tokën vinin e ia punonin dajat nga Sorica, që e donin fort nipin e tyre, Lucën. Por dhe Sorica, që ishte një grua punëtore, nuk e linte djalin e saj të vetëm të ngrinte as një fije kashte. Tjetërsoj u rrit Gjoka. Si i vdiq baba, ai përveshi mëngët, zuri parmendën, vuri mbi shpatulla shtëpinë dhe perëndia e ndihmoi, se po nuk punove, as Zoti nuk të shikon. U bë Gjoka shtëpi e parë në fshatin Lug, bile në tërë krahinën, se djersa, o lum miku, gjithmonë bëhet flori. U martua dhe lindi fëmijë. Martoi dhe të vëllanë që e kishte skifter si veten, motrat u rritën dhe

shkuan secila në punë të vet. Lusha, tepër e gëzuar, u vinte në ndihmë djemve e nuseve dhe rriti plot nipër e mbesa. Gjoka e respektonte shumë dhe të vëllanë nga nëna, Lucën. Ash-tu si dikur, nuk mund të rrinin pa njëri-tjetrin, kurrë nuk u doli fjalë e keqe nga goja. Por Luca nuk punonte, kishte qejf të bënte muhabet, arat i linte shkretë dhe më e keqja ishte se nuk po martohej. Pas disa vjetësh Sorica vdiq me një brengë të madhe në zemër, se e la të birin shkop e çikël e pirçakmak⁹. Gjoka bëri ç'bëri e martoi vëllanë, Lucën, ia bëri dasmën vetë, bash si dasmën e vet. U bë dhe me fëmijë, por mbeti ashtu i varfër e fakir. Më së shumti rrinte në shtëpinë e Gjokës, ndante kanun me miqtë që vinin shpesh te i vëllai, se dihet që, ku ka shporta fiq, gjithë bota bëhen miq.

Sa mirë e gjente Luca llafin në shtëpinë e Gjokës! Gjoka ishte gjithmonë në punë, se donte të mbante në këmbë ekonominë e mos t'i binte dora nën gurë. Yrsh te ara, yrsh te vatha. Ndërsa Luca, sa zbardhte drita, dilte nga shtëpia e tij dhe ulej këmbëryq në vatrën e Gjokës, mbushte ibrikun me kafe dhe fillonte të thithte pa pushim duhanin e fortë, duke e mbushur që në mëngjes konakun me shtëllungat ymi. Aty hante dhe drekën. Kishte qejf t'i shkonin Gjokës sa më shumë miq. Dhe i shkonin, se i ndilte më shumë Luca. Bile, dhe ndonjë mik i Lucës shkonte tek Gjoka, se aty ishte sofa. Kur vinte në mbrëmje Gjoka nga puna, tërë djersë e i lodhur, e gjente odën e burrave plot miq dhe Lucën që u jepte muhabet. Në të vërtetë, Gjoka e donte Lucën, nuk ia prishte kurrë. Aso kohe respektohej shumë më i madhi, prandaj dhe Gjoka e nderonte aq shumë Lucën, vetëm pse ishte dy muaj më i madh.

Nganjëherë edhe zorrët e barkut përzihen dhe e vjella vjen shpejt. Gjoka po shikonte se vëllai i tij po e tepronte dhe aq më keq se kishte lënë dhe familjen e tij pas dore. Gruaja e Lucës filloi të ankohej te kunati për burrin e saj që kishte harruar shtëpinë e tij e po humbiste kohën ashtu kot.

- Aman, o mixha Gjokë, mbyllja derën, se po më le fëmijët pa bukë.

Kaq është vrapi i guas. Nuk është mëngjesi e mbrëmja përherë njësoj...

- Eh, moj nusja e Gjokës! Po më flet jerm më duket. A nxirret jashtë vëllai? S'kemi zbritur gjer atje sa të bëhemi gazi i hallkut, - i pat thënë kohë më parë Gjoka kunatës.

Ditët po ecnin me vrap dhe gjërat nuk po ndryshonin. Luca rrinte kular gjithë ditën rreth vatrës së konakut të Gjokës dhe vetëm vonë, kur i vinte gjumi, kujtohej për të shkuar në shtëpinë e tij.

Erdhi një ditë që, siç thonë, të plas damari i durimit. Dhe a e dini ku është ky Damari i Durimit? Një gisht burri mbi lulen e ballit, pak më anash mbi

vetullën e majtë. Shikohet vetëm kur plas. Dhe kur plas një re e zezë errëson sytë dhe atëherë i duruari shpërthen, shpërthen...

Gjoka kishte ruajtur një dash të mirë tërë verë në bjeshkë dhe asaj vjeshte deshte ta forconte¹⁰ patjetër djalin e tij që akoma s'i kishte mbushur të shtatëmbëdhjetat dhe mendonte që këtë dash t'ua therte miqve të tij të parë që i kishte sajuar prej vitesh për t'u lidhur me ta. Këtë mendim e ruante vetëm për vete, s'ia kishte shfaqur as Lushës dhe kishte, siç themi ne sot, "sekret zemre". Ishte fundi i tetorit, gjëja e gjallë kishin zbritur nga staret e bashkë me to edhe bulmeti, që shyqyr Zotit atë mot kishte ardhur tepër i mbarë. E, se ç'bluante në mendje Gjoka kur jepte e merrte gjithë ditën për t'u mbledhur atij dimri? Ishte e enjte dhe, si zakonisht, kishte dalë në pazar. Shiste e blinte se dhe për këso punësh nuk kishte ortak. Ishte nisur pa zbardhur dita dhe po vonohej e s'po kthehej.

Sa ra mbrëmja ia befën një palë miq e bujrim në konakun e Gjokës:

- A do miq, oj shtëpi? - u dëgjua një zë tek porta e jashtme.

- Bujrim, bujrim e mirë se ju sollti Zoti! - brofi tërë gëzim e me një frymë Luca u gjet para tre burrave që i njihje mirë se ishin byraserë të babës. I futi në konak, u ndezi zjarrin, u qiti së pari nga një kafe dhe, kur e pa se Gjoka po vonohej u turr drejt vathës, rrëmbeu dashin me dy pash birë, e nxori në oborr të kullës dhe, sa hap e mbyll sytë e rropi, e bëri copë dhe ia çoi Lushës ta fuste menjëherë në kusi e të përgatitej se ishin miq të rrallë.

Pas nja dy orësh erdhi Gjoka dhe, sa hyri në oborr, rrotulloi sytë rreth avllisë dhe pa të varur në një kunj lëkurën e dashit të tij. E njihje mirë se vetë e kishte rritur për tre vjet dhe e kishte bërë tre pash dash. I shkoi mendja se ia paskësh prerë ujku. U merrzit shumë dhe po sillej rrotull lëkurës. Kur hyri në konak pa tre miqtë që ishin rehatuar në dy anët e oxhakut dhe Lucën që po u tregonte nga ata historitë e katundit. Gjoka ishte nga ata burra që gëzoheshin kur shkelte miku në derë, i priste dhe i përcillte me bujari malësori, por ama te dashi nuk mund të duronte. Ishte gati të priste tërë vathën, por jo dashin. Kur shkoi e takoj Lushën dhe pa gjithë atë dash që po ziente në kazan, turfulloi keq dhe filloi të kafshojë mustaqet me dhembë. Me këtë veprim ai përpiquej ta largonte sikletin e zemërimit. E kuptoi se Lusha nuk kishte faj, se kjo ishte punë e Lucës, që, siç i thoshin të tjerët, ia kishte zgjatur shumë sqepin vëllait.

- Ma thirr pak Lucën! - i tha djalit të vogël. - Le të dalë pak jashtë. Thuaj se të kërkon Lala.

Doli jashtë Luca me një kapotë të murrme supeve dhe të dy vëllezërit u ndodhën para lëkurës së dashit:

- Ç'është kjo, Lucë?

- Po dash është, o Gjokë, ai dashi i madh.

- Ky dash i madh është dashi im, o vëlla. Vetë e kam rritur. Ky dash, o vëlla, ka një pikë në ballë...

- Nuk i dallova pikë në ballë, o Lalë.

- Lucë, Lucë! Ky dash ka një pikë në ballë dhe ke bërë shumë gabim që s'e ke parë.

Të dy, si asnjëherë tjetër, u ndodhën ballë për ballë me sy të përplotur nga zemërimi.

- Lucë, Lucë, po ta them son-te dhe merre vesh mirë. S'ka më "puno Gjoka e ha Luca". Hajt, Lucë, bërxi në shtëpinë tënde! Hajt, Lucë, se më ka ardhë shpirti në majë të hundës. Hajt, Lucë, se e mbushe pil për pil kupën.

- Lalë, por... unë...

- S'ka lalë e shalë më te Gjoka. S'ka më: puno Gjoka e ha Luca. Tash shko në konak, se na e marrin vesh miqtë e s'e kemi zakon të koritemi.

Të dy hynë në konak e filluan të bëjnë muhabet, por bardaku tashmë ishte thyer. Miqtë kuptuan a s'kuptuan gjë, mishin e dashit e hëngrën me krye e me bisht. Vetëm Luca dukej si i vrrarë. Këtë e vunë re dhe miqtë, por po u thoshte se kishte një dhimbje koke që i vinte si shpesh këto kohët e

fundit. Si mbaroi darka, Luca mori leje e doli dhe shkante rrugës duke belbëzuar: ...Po, besa pooo... Puno Gjoka e ha Luca... Puno Gjoka e ha Luca, puno... Këtu i ra njëra këmbë në ujë dhe kur uli kokën pa se ndodhej tek vija e kopshtit të tij, që ishte tharë me rrënjë e degë. U fut në shtrat dhe nga mesnata u zgjua i mbytur në djersë. Se Luca ishte njeri me sedër.

Këto fjalët "Puno Gjoka e ha Luca" ishin thënë në mesnatë, kur s'kishte fé njeriu afër. Ishte thënë ashtu nën zë, siç i flet vëllai vëllait, ishin thënë mes dy burrave që kishin kaluar një jetë të tërë bashkë dhe as që mendonin se nata ka veshë e sy, se ato fjalë të thëna në errësirë do të fluturonin kaq shpejt e do të merrnin dhenë. Kaluan shekuj, por shprehja "Puno Gjoka e ha Luca" ka mbetur e vazhdon të jetojë për të treguar se në shoqëri e kudo nuk duhet përfutuar nga djersa e mudi i të tjerëve. Ja, pra, Gjoka e Luca nuk jetojnë më, por emri i tyre është gdhendur në kujtesën e brezave e do të jetojë përjetë. Sot emri i tyre përmendet, por askujt nuk i shkon në mendje se si lindi dhe si po jeton sot e asaj nate ajo shprehje e thënë mes dy vëllezërve të katundit Lug.

Shpjegim fjalësh e shprehjesh:

1. U binin syve - është kjo një lloj yshtjeje që fëmija për të mos u marrë mësysh kalohet dora e djathtë mbi sy për t'i prerë hovin syrit të keq.
2. Akran-i, ët, em. - ishin të një moshe, të lindur për afërsisht brenda një kohe, muaji a viti.
3. Soricën e Lushën - ishte tabu në Dibër të thirrej me emrin e saj të vërtetë gruaja e shtëpisë dhe një eufemizëm i natyrshëm që ajo të thirrej e të quhej me emër tjetër sa shkelte në shtëpinë e burrit, me emrin e katundit a të fisit nga vinte, siç është në rastin tonë Sorica, se ishte nga katundi Soricë i Dardhës dhe Lushë, se ishte nga fisi Lusha në Reç.
4. Hukubet - njeri a kafshë me përmasa të jashtëzakonshme, që ngjall habi e shpesh neveri tek të pranishmit.
5. Postel, i, et, emf. - një lloj pelteje e thatë që përgatitej me kumbulla të shtrydhura e ruhej për dimër.
6. Ndërronte vathë (Lami) - ndërronte vendin e fjetjes. Burrat që kishin dy gra shkonin një natë ose një javë tek njëra grua për të fjetur dhe një natë ose një javë tek tjetra.
7. Pa shoshë - shikohej lehtë, nuk e pengonte kush.
8. Në kolirin e vet - afër vatrës ku ndizet zjarri, pjesa e përparme e oxhakut.
9. Shkop e çikël - të vetëm, burrë e grua, pa njerëz e pasuri.
10. Pirçakmak = të varfër, pa asnjë pasuri.
11. Forcoj-forcova, -uar, hem, fl. = fejoj-fejohem, fejuar.

Për një shoqëri të vërtetë do të bëja sakrificë të mëdha

Ndihem vërtet e vogël për të shpjeguar dhe kuptuar botën në të cilën jam. Këtë botë që po bëhet çdo ditë e më tepër një shkretëtirë e pafund, ku me mundim mund të gjejmë ndonjë oaz të veçuar mirësie dhe dashurie... ndoshta, ndoshta një shoqëri, një forcë të madhe jetësore, që pavarësisht nga dramati dhe tragjeditë të cilat është e lidhur për shkak të rrethanave, mbart në vetvete një gëzim të pafund, një zjarr jetësor, veti e lindur e shpirtit njerëzor, por që kërkon edhe vitalitet shpirtëror që të lulëzojë. Lufta për një shoqëri të vërtetë rrit personalitetin e njeriut, ngre lart dinjitetin e tij, e frymëzon atë për vepra të mëdha, për liri e progres shoqëror. Më kujtohen fjalët e Eskilit tek Prometeu:

Më parë njerëzit kishin sy dhe s'ishkonin, kishin veshë dhe asgjë s'dëgjonin, si hije ëndrrash krejt të mjegulluara, të turbullta, të mjera zvarriten, nga njëri brez në tjetrin...

Ndërsa sot... A mos vallë sakrificë e tij për të hedhur dritë në komunitetin ku jetonte e shndërroi qenien në njeri? Pa sakrificë, asgjë nuk mund të përparojë. Ajo ka aftësi të zbuluorë e të shndërrorë edhe gjërat më të rëndomtë. Nuk më trembet syri as nga pengesat, as nga rreziqet. Të gjitha më duken fushë me lule, kur para meje më shfaqet imazhi i një shoqërie që ia vlen të quhet e tillë. Jam e gatshme t'i çjerr maskën e natyrës, të hyj në thelbin e saj për të ngritur në fronin më të lartë të pushtetit, një shoqëri të pastër e të singertë. Madje jam e gatshme të shkel me këmbë yje gjeneralësh dhe kurora mbretërisht, për t'u treguar të gjithëve se nuk ka jetë pa sakrificë. Pa sakrificë jeta mbaron.

Vojsava Leka

Zbulohen dy përkrenare ilire në themelet e "Rrugës së Arbërit"

Nga ERMIR HOXHA

Zbulimi i një varri antik gjatë punimeve për Rrugën e Arbërit ka zgjuar "ethet e arit" te banorët e një zone në veri të vendit, të cilët thuajse e kanë shkatërruar një varr antik të sapozbuluar. Situata e krijuar pikërisht në fshatin Sofraçan, ka bërë që policia të marrë përsipër mbrojtjen e këtij varri, i cili mund të bëhet objekt shkatërrimi ose vjedhjeje, duke sjellë kështu zhdukjen e disa vlerave kombëtare. E gjithë kjo ka filluar para pak ditësh. Një firmë ndërtimi, e cila ka fituar tenderin për ndërtimin e Rrugës së Arbërit, po punonte në zonën e fshatit Sofraçan. Makineritë, duke gërmuar për shtrimin e rrugës, kanë pikasur disa pllaka varri, që punëtorët e i kanë larguar tutje, për të parë se çfarë kishte brenda tyre. Pikërisht në atë vend, një nga punëtorët e firmës ka gjetur dy përkrenare bronzi, të mbajtura në kushte mjaft të mira. Fillimisht, pas heqjes së pllakës, punëtorët kanë gjetur një përkrenare, të cilën e ka marrë një punëtor krahu, që quhet Florenc Hatija. Më vonë aty janë afruar edhe punëtorët e tjerë, të cilët kanë nisur të gërmojnë në varrin arkeologjik. Një tjetër punëtor, Ruzhdi Bitri, ka gjetur një tjetër përkrenare, duke e mbajtur nën kujdes, pasi sipas tij ajo përbën një vlerë kombëtare. Por, e gjithë kjo histori ka sjellë interes të gjithë punëtorët, të cilët kanë filluar të gërmojnë me shpresën se brenda do të gjenin flori. Madje, një fjalë e tillë është përhapur edhe në fshat, ku banorët kanë dëgjuar se aty ka qypa me flori që kanë mbetur që në kohën e ilirëve. Kaq është dashur që ata të tentojnë të hyjnë në zonën e zbuluar dhe të kontrollojnë për floririn e ëndërruar. Megjithatë, ata nuk ishin të vetmit që kanë shfaqur interes për varrin arkeologjik. Interesi është rritur edhe te punëtorët, ku njëri prej tyre është larguar natën bashkë me përkrenaren. Ai nuk ka pranuar ta dorëzojë, duke pretenduar se ajo ishte vetëm një teneqe për t'u hedhur. Ndërsa banorët që të nesërmen janë sulur duke kërkuar gjëra me vlerë dhe duke dëmtuar rëndë varrin antik. Kjo situatë kritike ka alar-

muar edhe arkeologët, ku sipas të dhënave kanë kërkuar ndihmën e policisë. Këta të fundit bënë të ditur se pas dëmtimit të parë të varrit antik, tashmë ai është marrë nën mbrojtje. Megjithatë, ende nuk dihet nëse janë shpëtuar gjithë sendet me vlerë të këtij varri, apo janë bërë objekt vjedhjeje. Autoritetet policore kanë ngritur dyshimet se bashkë me përkrenaret mund të ketë pasur edhe shtiza luftëtarësh, për të cilat mendohet se mund të jenë vjedhur. Megjithatë, kjo mbetet në kuadrin e dyshimeve, derisa të dalin në një konkluzion ekspertët e arkeologjisë. Nga ana e saj, policia bëri të ditur se ka nisur një hetim në lidhje me "vjedhjen" e njëjës përkrenare, pasi tjetra është gjetur dhe mbahet nga një punëtor. Sipas arkeologëve, të kontaktuar menjëherë pas lajmit, theksohet se në këtë zonë është kalaja historike e Sofraçanit, e cila i përket periudhës ilire dhe kohës antike të vonë. Ndërsa për dy përkrenaret e gjetura aty, arkeologët mendojnë se janë të shek. V-IV para Krishtit. Në lidhje me këtë rast, uniformat blu kanë nisur punën për identifikimin e personave që mund të kenë ndërhyrë në varrin antik, duke e shkatërruar atë, që për arkeologët ka vlera me shumë rëndësi. Madje, grupi hetimor ka marrë në pyetje disa persona, të cilët mund të kenë dijeni për ngjarjen flagrante. Por, deri dje nuk ka pasur ndonjë emër konkret për policinë, kështu që kjo e fundit është e detyruar të mbajë nën vëzhgim këtë zonë, derisa ajo të merret plotësisht në mbrojtje nga autoritetet e arkeologjisë, që do të kryejnë kërkime të tjera.



Arkeologu dibran, Prof. As. Dr. Adem Bunguri në vendin ku u zbuluan dy përkrenaret, duke folur me disa punonjës të firmës ndërtuese

Flet Ruzhdi Bitri, një nga poseduesit e vlerave të zbuluara "Përkrenaren do t'ia dorëzoj shtetit me ceremoni"

Ruzhdi Bitri kishte fatin të ishte i dyti person të cilit i ra në dorë përkrenarja e dytë e gjetur në trasenë e rrugës në ndërtim, atë të "Arbrit". I mbajtur si një dibran tipik, me nder e besë e njëfarë "intelektuali malesh" për shkak të profesionit prej mësuesi letërsie e me një afekcion të veçantë për shkencat filologjike, ai premtonte se do ia kthejë shtetit, më saktë Institutit të Arkeologjisë, atë çka gjeti pasditen e 21 shkurtit. "Do ia kthej me ceremoni, m'u aty ku u zbuluan, por dua që të më njihet autorësia e aktit të ruajtjes dhe kthimit të tyre", shprehet Bitri, të cilit këto ditë i bie telefoni më shumë se zakonisht nga persona që interesohen për vlerat që ai posedon. "Nuk më ka shkuar në mendje të bëj trafik me përkrenaren. Unë e di vlerën e tyre. E di që ato i përkasin trashëgimisë dhe kul-

turës kombëtare. Arsimimi dhe formimi që kam nuk më lejon të bëjë pazare me vlera të tilla", shprehet Bitri, që gjithsesi nuk ka dëshirë t'i përmendë emrin kolegut, i cili është larguar në mënyrë klandestine nga puna së bashku me përkrenaren e gjetur. Zbulimi i parë, thotë Bitri, ndodhi aty nga ora 16:00 e pasdites së datës 21. Unë nuk isha në vendngjarje, por më thirrën dhe erdha. Objektin e gjetur e kishte marrë një prej punëtorëve që kish qëlluar afër tij. Ne u përpoqëm shumë ta bindnim që objekti duhej t'i kthehej shtetit, përkatësisht arkeologëve, por ai e mbajti si pronë të tijën. Por, aty nga mesnata, kur ne u ngritëm e dolëm në front për shkak të një avarie, ai nuk gjendej në shtrat. E telefonova dhe më tha se ishte nisur për në shtëpi për një hall familjar. Në fakt, nuk kam të drejtë ta paragjykoj se vërtet kishte hall. Sa për fatin e objektit që ka marrë me vete, flisni vetë me të, nëse e njihni", thotë Bitri. Veç përkrenares, ai posedon si gjetje edhe ca qeramika, ndërkohë që te gjetjet përfshihen dhe ca eshtra e një kafkë. Si i pasionuar pas historisë, Bitri rreket të përcaktojë dhe ai një datim të përafërt të zbulimeve, me aq njohuri sa zotëron nga fusha. Por i bindur është që ato janë ilire. Tashmë, pasi është "ngopur" duke i poseduar personalisht ato vlera të rralla, ai po projektton në mendje ceremoninë e dorëzimit të tyre, që do shërbejë dhe si një apel për të gjithë ata ndërtues rrugësh, të cilët hasin në gjetje të tilla e që përveç faktit që nuk lajmërojnë specialistët sipas ligjit, edhe molepsen për t'i trafikuar. (Shqip)

FLET PER GAZETEN "SHQIP" "HAJDUTI" I PËRKRENARES

"Ishte prej teneqeje, fëmijët e shitën për skrap"

Punëtori që gjeti përkrenaren e parë në vendin e quajtur "Qafa e varreve", është nga Fieri dhe quhet Florenc Hatija. Në një bisedë telefonike me të, ai pranoi që e ka marrë objektin me vete. Por për Florencin, ajo nuk ishte përkrenare, por një tip teneqeje, apo një send prej hekuri, që ai siç tha, e kishte hedhur. Por këmbënguljes me pyetje për ta ditur se ku e kish hedhur (që të mundet të shkojnë ta marrin specialistët e arkeologjisë), ai iu përgjigj se "ishte hedhur në plehra, por fëmijët e kishin marrë dhe e kishin shitur për skrap. Hatija u largua drejt shtëpisë natën, disa orë pasi u gjet përkrenarja, të cilën ai e mori me vete. Dhe sipas fjalëve të vetë Hatisë, i bie që ai të ketë udhëtuar nga Bulqiza drejt Fierit me një teneqe me vete, që më pas është shitur për skrap. Gjithsesi, nga Instituti i Arkeologjisë thuhet se nuk është kompetencë e tyre të merren me precedentin e personit në fjalë. Po kush e ka ketë të drejtë?

DIBRANËT NUK E RRISIN ÇMIMIN E BUKËS

Dibra, ku bëjnë pjesë rrethet, Dibër, Bulqizë dhe Mat, është një ndër rajonet më të varfra të vendit, edhe pse resurset për mirëqenie të rreth 150 mijë banorëve të saj nuk mungojnë. Është pikërisht kjo varfëri ekstreme e këtij rajoni, që i ka detyruar prodhuesit e bukës në qytetet Peshkopi, Bulqizë, Mat, Klos, Maqellarë dhe Burrel, që të mos e ndryshojnë për momentin çmimin e bukës, siç ka ndodhur dhe po ndodh shpesh ditët e fundit në mjaft qytete të vendit tonë. Aktualisht, buka masive në furrat e këtyre qyteteve vazhdon të shitet me 70 lekë të reja, si edhe më parë. Shoqata e prodhuesve të bukës ka vendosur që të mos e rrisë për momentin çmimin e saj, edhe pse një gjë të tillë ata e përballojnë me mjaft vështirësi dhe fitim minimal. Kjo për faktin se situata në të cilën ndodhen prodhuesit e bukës, kur çmimi i miellit, vajit dhe lëndës djegëse,

që kushtëzojnë këtë prodhim, kanë njohur vetëm rritje, po i çon furrarët drejt falimentimit të plotë të tyre. Të pyetur nga gazeta për ruajtjen e çmimit të bukës, njëri nga prodhuesit më të mëdhenj në qytetin e Bulqizës, Hamza Sula, tha se në mbledhjen e Shoqatës së Prodhuesve të bukës, u vendos që për momentin të ruhet çmimi i bukës duke marrë parasysh varfërinë e tejskajshme të banorëve të këtij rajoni. Por në qoftë se nuk do të ndërhyhet nga qeveria për të ndikuar në uljen sadopak të kostos së prodhimit të bukës, atëherë rritja do të jetë e pashmangshme. "Me rritjen e çmimit të miellit, që tashmë blihet me shumicë me 6100 lekë për quintal, nga 6000 që ishte ditë më parë dhe të vajit që nga 100 lekë për litër është bërë 220 lekë, pa llogaritur këtu transportin nga Tirana në Dibër, marzhi i fitimit për ne ka rënë ndjeshëm, duke e bërë situatën e mosndry-

shimit të çmimit të bukës, të papërbalueshme nga ana e jonë" sqaron Hamza Sula. Sipas tij, kostoja reale e bukës ka shkuar nga 60 deri në 65 lekë të reja, duke e çuar fitimin e bukëpjeksëve në rreth 5 lekë për çdo bukë. Ndërkohë, banorët shprehen të kënaqur për ruajtjen e çmimit të shitjes së bukës, për të cilën falenderojnë prodhuesit e saj dhe kërkojnë që buka të shitet nga vetë këto furra të prodhimit, duke eliminuar kështu rritjen spekulative nga pikat ambulante të shitjes. Megjithatë, familjarët e këtyre qyteteve e kanë gjetur edhe një mundësi tjetër për t'u ruajtur nga rritja e mundshme e çmimit të bukës, atë të blerjes së miellit dhe gatimit të bukës në shtëpi, pasi kështu kostoja del me leverti se sa blerja e bukës me çmime më të rritura se 70 lekë.

"Shqip", 12 shkurt 2008